



2015



UDHËZIM PËR APLIKIMIN E RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN E TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE

Fushë Kosovë

2014



Përmbajtja

Neni	PJESA I-Dispozitat e Përgjithshme	Faqja
	Shkurtesat	4
1	Aplikimi i udhëzimit dhe dispozitat e përbashkëta	5
2	Shkollimi dhe mbikëqyrja e punëve të punëtorëve të cilët marrin pjesë në organizimin e transportit të udhëtarëve	5
3	Mjetet e punës	6
4	Formularët	6
5	Koha e punës	7
6	Orari i lëvizjes së trenave, frekuenca e udhëtarëve	7
7	Vendosja e tarifave (në shikim) dhe dhënia e informatave shfrytëzuese të transportit	7
8	Dhënia e informatave zyrtare	8
9	Kontestet dhe ankesat	8
10	Përcjellja e postës zyrtare	9
11	Ruajtja dhe përdorimi i formularëve dhe librave	9
12	Sigurimi i domosdoshëm i udhëtarëve, mënyra e veprimit të personelit në rast të fatkeqësive, lëndimi, vdekjes së udhëtarëve	10
13	Dispozitat administrative të doganave dhe veterinarisë	10
	PJESA II –Organizimi i Transportit te udhëtareve	
	A) Biletat	
14	Biletat e trenit për transport të brendshëm	11
15	Llojet e biletave të trenit për transport të brendshëm a) Dispozitat e përgjithshme b) Dispozitat e veçanta biletat e trenit të shtypura me të dhëna të plota janë: - K-2 (bileta me çmim të rregullt) - K-2 (bileta me benificion 50%) - K-2 (bileta kthyese me benificion 20%) biletat e trenit te të cilat disa të dhëna shkruhen janë: - K – 2a bileta të rëndomta - K – 6 bileta për pagesa plotësuese - K – 8b bileta fletë udhëtimi. biletat mujore	12

	- për nxënës dhe studentë - për punëtorë	
16	Biletat e trenit për transport ndërkombëtarë - bileta K-7	16
	B) Pranimi dhe përcjellja e udhëtarëve	16
17	Objektet, hapësira, salla e pritjes, peroni	16
18	Mirëmbajtja e rendit dhe pastërtisë në trena	17
19	Dhënia e biletave të trenit	17
20	Vulosja e biletave të trenit	20
21	Pagesa e çmimit të udhëtimit (transportit)	20
22	Benificionet e udhëtimit - mënyra e përdorimit a) benificionet ligjore b) benificionet komerciale c) benificionet tjera	21
23	Kërkesa për vagonë dhe tren të posaçëm a) vagon i posaçëm b) tren i posaçëm	24
	C) Vendosja dhe transporti i udhëtarëve	
24	Hyrja në vagonë dhe akomodimi i udhëtarëve	24
25	Personat të cilët largohen nga transporti ose barten me kusht	26
26	Bartja e gjallesave në vagonë të udhëtarëve	26
27	Udhëtimi pa biletë të rregull të trenit	27
28	Detyrat e konduktorit	27
29	Kontrollimi i biletave të udhëtimit në tren	31
30	Procedurat e pagesave shtesë në tren	32
31	Lajmi i parregullsisë	33
32	Revizorët e trenave	34
33	Ndërprerja e udhëtimit	37
34	Vërtetimi i vlefshmërisë së biletës dhe mos shfrytëzimi i saj	37
	D) Rastet e veçanta	
35	Mosrespektimi i orarit të lëvizjes së trenave – pengesat në komunikacion	38
36	Procedura kur udhëtari nuk pranon ta paguaj biletën shtesë në tren	41
37	Procedurat e veçanta për stacionet kufitare	44
38	Regjistri i biletave dhe formularëve të cilat përdoren në transportin e udhëtarëve	
39	Regjistri i biletave dhe formularëve të Transportit të Udhëtarëve	45
40	Detyrimet për pronarin e Infrastrukturës	45
	Pjesa e III Dispozitat përfundimtare	45

SHKURTESAT

Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim:

HK Trainkos - Hekurudhat e Kosovës Trainkos Sh.A

HK Infrakos - Hekurudhat e Kosovës Infrakos Sh.A

CIV - Konventa ndërkombëtare për transportin e udhëtarëve dhe bagazhit me hekurudhë

RID - Rregullorja për transportin e materieve të rrezikshme në komunikacionin e brendshëm dhe ndërkombëtar

TU - Tarifa e udhëtarëve

RIV - Rregullorja për përdorimin e përbashkët të vagonëve të mallrave në komunikacionin ndërkombëtar

PK - Policia e Kosovës

UKT - Udhëzimi për Komunikacion – Transport

Në mbështetje të Nenit 20 të Ligjit 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e ligjit 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe në bazë të nenit 26.23 të Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për NP, Bordi i Drejtorëve i HK TRAINKOS SH.A në Mbledhjen Nr. 49 të mbajtur më 23 dhe më 29.12.2014, miratoi këtë:

UDHËZIM PËR APLIKIMIN E RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN E TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE

Neni 1

Aplikimi i këtij udhëzimi dhe dispozitat e transportit të udhëtarëve

1. Transporti i udhëtarëve në HK- Trainkos Sh.A organizohet në bazë të Rregullores për Organizimin e Transportit të Udhëtarëve dhe dispozitave të këtij Udhëzimi.
2. Dispozitat e këtij udhëzimi vlejnë edhe për transportin ndërkombëtar të udhëtarëve nëse ndonjëra prej rasteve nuk është e rregulluar ndryshe me dispozita ndërkombëtare.
3. Me zbatimin e këtyre dispozitave gjatë transportit të udhëtarëve, duhet pasur kujdes për siguri, rregullshmëri, ekonomizim dhe shpejtësinë e transportit.
4. Nëse vjen deri te transportit i kombinuar hekurudhë- autobus, hekurudhë – aeroplan e tjera për këto transporte duhet të nxjerrën dispozita të veçanta.

Neni 2

Shkollimi dhe mbikëqyrja e punëve të punëtorëve të cilët marrin pjesë në organizimin e transportit të udhëtarëve

1. Punëtorët të cilët punojnë në transportin e udhëtarëve janë të obliguar t'i njohin të gjitha dispozitat që e rregullojnë transportin. Për këtë mbahet shkollimi i rregullt, gjithashtu në mënyrë të argumentuar informohen me ndryshimet dhe plotësimet shtesë, nga menaxherët përkatës.
2. Punëtorët e hekurudhës duhet të pajisen me dispozita të nevojshme (rregullore, udhëzim, tarifa, telemetër).

Neni 3

Mjetet e punës

1. Për kryerjen e punëve në transportin e udhëtarëve, varësisht prej kushteve të punës dhe specifikave të punës, konduktorët duhet të pajisen me këto mjete:

- Çanta;
- Çmimorja;
- Orari i lëvizjes së trenave;
- Biletat;
- Regjistri i dorëzimit K-93.

Neni 4

Formularët

1. Në transportin e udhëtarëve përdoren formularët të cilët janë të cekur në shtojcën e këtij udhëzimi. Formularët janë të shënuar me shkronjën "K" dhe numrin rendor. Në HK- Trainkos kemi këta formular: 1. të thjesht dhe 2. të evidentuar. Formularët e evidentuar duhet të vulosen me vulë të Trainkos-it.

2. Formularët duhet të plotësohen me stilolaps me ngjyrë të kaltër dhe në mënyrë të qartë.

3. Secila Biletari duhet të ketë sasi të mjaftueshme të formularëve në stoqe. Biletaria është përgjegjëse për të gjitha biletat dhe formularët e evidentuar.

4. Në rast të mungesës (humbjes) të ndonjë bilete ose formulari, punëtorit të cilit i është besuar puna, kompensimin do ta bëjë sipas vlerës tarifore të udhëtarëve dhe njëherit i ndalohet dhënia e biletave të trenit për kohën që është e paraparë me aktet normative të Trainkos-it.

5. Me vlerë tarifore të biletës nënkuptohet:

- a) Vlera tarifore e çmimit të biletës (për biletat K-2 të cilat janë të shtypura me çmim dhe relacion);
- b) Vlera tarifore e çmimit të biletës kthyesë, më së paku 20 udhëtarë të rritur, në relacionin më të gjatë (për biletat K-2a).

6. Në rast se gjenden biletat e humbura, punëtori përgjegjës mund ta bëjë kërkesën pranë kompanisë për kthim duke i arsyetuar detalisht.

Neni 5

Koha e punës

Koha e punës për biletari duhet të ekspozohet në vendet e dukshme.

Neni 6

Orari i lëvizjes së trenave, frekuenca e udhëtarëve

a) Orari i lëvizje së trenave

1. Në çdo stacion, në vendet zyrtare që shërbejnë për udhëtarët (Lokalet, hapësirat, salla e pritjes) me kohë duhet të ekspozohet ekstrakti i orarit të lëvizjes së trenave.
2. Në rast të ndaljes së përkohshme të ndonjë treni, apo futjes së përkohshme të ndonjë treni në qarkullim duhet të ekspozohet njoftimi tek orari i lëvizjes së trenave.
3. Përveç orarit të lëvizjes së trenave në stacione aty ku është e nevojshme duhet të ekspozohet orari i transportit ndërkombëtar edhe orari i trafikut të transporteve tjera të udhëtarëve.

b) Frekuenca e udhëtarëve

Të dhënat mbi frekuencën e udhëtarëve në HK-Trainkos shërbejnë për përcaktimin e numrit të trenave dhe vagonëve.

Neni 7

Vendosja e tarifave (në shikim) dhe dhënia e informatave shfrytëzuese të transportit

1. Stacionet janë të obliguara që me kërkesën e udhëtarit t'i japin në shikim tarifat të vlefshme.
2. Të gjitha informatat të cilat japin stacionet duhet të jenë të sakta dhe të kuptueshme. Njoftimet të cilat janë të dedikuara për punët e personelit hekurudhor, lidhur me udhëzimet rregulloret dhe urdhëresat tjera nuk guxojnë t'u jepen udhëtarëve.
3. Konduktorët në tren duhet t'i njoftojnë udhëtarët sipas kërkesës së tyre për orarin dhe kushtet e udhëtimit.

4. Të gjitha biletaritë duhet të publikojnë në vend të përshtatshme tabelat tarifore (çmimoren). Gjithashtu tabelat tarifore duhet të publikohen edhe në vendqëndrime të trenit sikurse në stacione.

Neni 8

Dhënia e informatave zyrtare

1. Stacionet nuk guxojnë t'i mundësojnë shikimin e dokumenteve, librave zyrtare përveç zyrtarëve të hekurudhave dhe organeve të shtetit të cilat janë të autorizuar (ATK-ja, gjykatat, organet e punëve të brendshëm, etj.).
2. Për dhënien e shënimeve të nevojshme organeve të tjera, ato duhet t'i drejtohet kompanisë me shkrim pastaj ajo vendos për dhënien e shënimeve të kërkuara.

Neni 9

Kontestet dhe ankesat

1. Kontestet në stacione në mes të udhëtarëve, udhëtarëve dhe personelit hekurudhor i rregullon shefi i stacionit respektivisht punëtori i autorizuar i stacionit. Kontestet në tren në mes të udhëtarëve i rregullon konduktori, ndërsa në mes të udhëtarëve dhe personelit hekurudhor i rregullojnë revizorët, kontrolli në tren, nëse këta nuk janë në tren atëherë kontestet i rregullon personeli i stacionit sipas pikës 1 ku treni ndalet në stacionin e parë sipas orarit. Të gjitha kontestet duhet të shqyrtohen korrekt dhe me procedurë të shpejt.
2. Udhëtarët mund të bëjnë ankesë në formë verbale dhe me shkrim. Ankesat verbale duhet të shqyrtohen menjëherë në vend të ngjarjes.
3. Ankesat me shkrim në stacione udhëtari i vendos në kutinë e ankesave apo i dorëzon te shefi i stacionit apo te drejtuesi i trenave. Personeli hekurudhor ankesat e veta nuk mund t'i vendos në kutinë e ankesave por të njëjtën e dërgon zyrtarisht në departamentit përkatës.
4. Nëse udhëtari ka vërejtje gjatë udhëtimit në tren ai mund të bëjë ankesë me shkrim dhe ta vendos në kutinë e ankesave të cilat janë të vendosura në vagonë. Personeli i autorizuar nga sektori i transportit të udhëtarëve duhet t'i kontrolloj për çdo 7 ditë kutitë e ankesave në vagonë dhe t'i procedojë më tutje tek menaxheri i sektorit.

Neni 10

Përcjellja e postës zyrtare

1. Me postë zyrtare nënkuptojmë shkresat zyrtare, shtypin zyrtar, (tarifat, orarin e lëvizjes së trenave, broshurat, statistikat e komunikacionit dhe transportit hekurudhor), dokumentet llogaritëse, biletat e udhëtimit dhe materialet propaganduese, (prospektet, broshurat) të cilat janë të lidhura me shërbimin hekurudhor, të cilat kompania hekurudhore i dërgon dhe i pranon nga njësitë tjera.
2. Shkresat zyrtare lidhur me transportin e udhëtarëve dërgohen përmes postës zyrtare me hekurudhë.
3. Çdo shkresë zyrtare në komunikacionin e brendshëm në anën ku është adresa duhet t'i ketë këto shënime:
 - Në këndin e majtë, në anën e sipërme adresën e saktë me emrin e organit i cili e dërgon shkresën si dhe të vulosur me vulën e kompanisë.
 - Nën emërtimin e organit i cili e dërgon shkresën duhet të ketë numrin dhe datën e përcjelljes së shkresës.
 - Në anën e djathtë duhet të ketë adresën e saktë kujt i dërgohet shkresa e plotësuar me germa të shtypit.
4. Pranimi dorëzimi i postës zyrtare mes të personelit të stacionit dhe atij të trenit bëhet me regjistrin e dorëzimit K-93. Regjistri K-93 plotësohet në dy kopje, origjinalin e mbanë personi i cili e dorëzon postën zyrtare, ndërsa kopjen e merr pranuesi i postës zyrtare.

Neni 11

Ruajtja dhe përdorimi i formularëve dhe librave

1. Formularët dhe librat e përdorura për transportin e udhëtarëve duhet të ruhen në bazë të ligjit mbi Arkivin.
2. Nëse për ndonjë lëndë, hetimet janë në vazhdim, të gjithë formularët dhe librat të cilat kanë të bëjnë me atë lëndë, duhet të ruhen deri sa lënda të përfundojë plotësisht.

Neni 12

Sigurimi i domosdoshëm i udhëtarëve në hekurudhë, mënyra e veprimit të personelit në rast të fatkeqësive, lëndimi, vdekjes së udhëtarëve si pasojë e një aksidenti

Dispozitat hyrëse

1. Me dispozitat ligjore të sistemit të sigurimit të personave edhe pasurisë është paraparë sigurimi i domosdoshëm i udhëtarëve në komunikacionin publik, i cili përfshinë edhe sigurinë e udhëtarëve të cilët udhëtojnë me hekurudhë.
2. TRAINKOS-i me kohë lidhë kontratat e duhura për sigurimet e detyrueshme të udhëtarëve me kompanitë e sigurimit.
3. Sipas dispozitave, të siguruar nga aksidentet konsiderohen personat të cilët gjatë udhëtimit ndodhen në njërën prej mjeteve të transportit publik, pavarësisht nëse ata kanë një biletë apo jo, pastaj personat të cilët janë në afërsi të stacionit apo në afërsi të konsiderueshme të mjetit transportues, respektivisht, pas daljes nga treni për të cilin vërtetohet se kanë pasur qëllim të udhëtojnë me mjetin përkatës të transportit, ose kanë udhëtuar me të njëjtin. Në paragrafin e mësipërm, hyjnë edhe personat që kanë të drejtë të udhëtojnë pa pagesë.
4. Bartësit e biletave ndërkombëtare janë të barabartë me bartësit e biletave në komunikacionin e brendshëm.

Neni 13

Dispozitat administrative të doganave dhe veterinarisë

1. Në shikim të kryerjes së veprimeve doganore, veterinarë vlejné rregulloret dhe ligjet e doganës dhe veterinarisë.

PJESA II B
ORGANIZIMI I TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE

A) Biletat e trenit

Neni 14

Biletat e trenit për transport të brendshëm

Dispozitat e përgjithshëm

1. Bileta e udhëtimit është dëshmi për lidhjen e kontratës për transport, e cila i jep të drejtë udhëtarit për udhëtim me hekurudhë në afatin, relacionin e caktuar, për klasën dhe llojin e trenit. Në pamje të formatit, madhësisë, renditja e tekstit, ngjyra dhe lloji i letrës, biletat e trenit janë të një formati.
2. Me rastin e përcjelljes së udhëtarit përdoren biletat e trenit të shtypura me shënime të plota dhe biletat e udhëtimit ku disa shënime duhet të plotësohen. Biletat e trenit sipas rregullave përmbajnë këto shënime:
 - Stacionin e nisjes dhe atë destinues
 - Llojin dhe klasën e trenit
 - Çmimin
 - Ditën e parë të vlefshmërisë
 - Afatin e vlefshmërisë
 - Numrin rendorë
 - Shenjen e biletarisë
 - Vulën (shenjen) e thatë e kompanisë
 - Rrugën kaluese
 - Beneficionet
3. Afati i vlefshmërisë së biletave të trenit fillon nga data e vulosur me vulë të stacionit, respektivisht nga data e cila është shënuar në biletën e trenit si dita e parë e afatit të vlefshmërisë. Te biletat e trenit të cilat nuk vulosen afati i vlefshmërisë fillon nga data e dhënies, respektivisht nga shikimi (ekzaminimi) i parë. Vula me datë në biletë duhet të jetë e qartë dhe e lexueshme. Dita e parë e vlefshmërisë llogaritet si ditë e plotë. Udhëtimi mund të fillojë në cilëndo ditë të afatit të vlefshmërisë së biletës së trenit. Udhëtimi duhet të kryhet më së voni me trenin i cili sipas orarit të lëvizjes së trenave arrin në stacionin destinues deri në ora 24:00 të ditës së fundit të vlefshmërisë së biletës së trenit.
4. Bileta e trenit vlen për rrugën kaluese për të cilën është cekur në biletë. Nëse udhëtari shfrytëzon rrugën më të gjatë të udhëtimit paguan pagesën shtesë sipas tarifës.

5. Udhëtimi mundë të filloj edhe nga stacioni i cili është më afër nga stacioni i nisjes e i cili gjendet në të njëjtën rrugë kaluese.
6. Bileta e trenit e lëshuar me emër nuk mund të shfrytëzohet nga personi tjetër pa marrë parasysh se a ka filluar udhëtimi a jo.
7. Teksti në bileta të trenit të shtypura me shënim të plotë sipas rregullave nuk mund të ndërrohet. Çmimi në biletat e trenit me shënime të plota mund të ndryshoj në rast të rritjes apo zbritjes së tarifave apo ndërrimit të telemetrit, me përmirësim me rastin e dhënies me laps kimik apo me vulë valide.
8. Me rastin e plotësimit të biletës së trenit shënimet e shkruara duhet të jenë të qarta dhe të lexueshme dhe nuk guxojnë të përmirësohen apo fshihen. Me biletat e plotësuara gabimisht dhe gabimisht të vulosura duhet të shkruhet "X" mbi biletë dhe të shkruhet mbrapa biletës nëse është "plotësuar gabimisht" apo "gabimisht të vulosura" dhe të vërtetohet nga shefi i stacionit për biletari, kurse për konduktorë nga përgjegjësi i konduktorëve. Bileta nuk duhet të shqyhet nga blloku.
9. Biletat e trenit në komunikacionin e brendshëm, shtypen në gjuhën shqipe dhe serbe.

Neni 15

Llojet e biletave të trenit për transport të brendshëm

1. Për përcjelljen e udhëtarëve në komunikacionin e brendshëm përdoren këto bileta:

a) Biletat e trenit të shtypura me të dhëna të plota

- K-2 (bileta me çmim të rregullt)
- K-2 (bileta me beneficion 50%)
- K-2 (bileta kthyesë me beneficion 20%)

Bileta K-2 janë bileta me shënime të shtypura, përdoren vetëm nga stacionet, në rast të dhënies së biletës plotëson vetëm disa shënime siç janë; afatin e vlefshmërisë së biletës dhe vulos me vulën me datë.

b) Biletat e trenit të cilat disa të dhëna duhet të shkruhen janë:

- K-2a bileta të rëndomta
- K- 6 bileta për pagesë plotësuese

- K-8b biletë fletë udhëtimi

Bileta K-2

Biletat e trenit të shtypura me të dhëna të plota

- K-2 (bileta me çmim të rregullt)
- K-2 (bileta me beneficion 50%)
- K-2 (bileta kthyese me beneficion 20%)

Bileta K-2 janë bileta me shënime të shtypura përdoren vetëm nga stacionet, në rast të dhënies së biletës plotëson vetëm disa shënime siç janë; afatin e vlefshmërisë së biletës dhe vulos me vulën me datë.

Formulari K-34 përdoret për evidentimin e biletave të shitura K-2.

Biletat K-2a

1. Për përcjelljen e udhëtarëve sipas çmimit të rregullt ose të beneficionit të lartësive (relacioneve) të njëjta atëherë përdoret bileta K-2a.

2. Bileta K-2a jepet si:

1)Një biletë në rast:

- Për udhëtim në një drejtim nëse biletaria nuk posedon biletë K-2 për relacion të caktuar,
- Për biletë kthyese nëse biletaria nuk disponon biletë K-2 për relacion të caktuar,
- Për udhëtim grupor dhe kolektiv
- Për biletë mujore për nxënës dhe punëtorë

Bileta K-2a është formular strikt i vulosur dhe përbëhet prej dy fletëve:

- Amëza
- Biletë udhëtimi

Të dy fletët e mbajnë numrin e njëjtë. Secila biletari duhet ta ketë numrin rendor të vetë duke filluar prej 00001 deri në 10 000 të lidhura në bllok nga 50 copë dhe të vulosura me vulë të thatë (logo) të Trainkos Sh.A.

Amëza është me ngjyrë të bardhë ndërsa bileta e udhëtimit është me ngjyrë rozë.

Amëza shërben si bazë për llogaritje.

Biletë udhëtimi K-2a i jepet udhëtarit.

Bileta K-2a plotësohet në biletën amzë me laps kimik me ngjyre të kaltër ose të zezë por pa e futur indigon sepse bileta e udhëtimit përmban karbon, gjithmonë para se të plotësohet bileta duhet të vendoset një karton pas biletës së udhëtimit për arsye që shënimet mos të kalojnë në biletën tjetër. Plotësimi i biletave duhet të bëhet në mënyrë të qartë dhe të lexueshme. Ndalohet fshirja dhe përmirësimi i shënimeve të shënuar në biletë.

Me një biletë K-2a mund të kryhet pagesa deri në 6 udhëtarë të cilët udhëtojnë për një stacion destinues, bashkudhëtues në klasën dhe trenin e njëjtë si dhe shfrytëzojnë beneficinin e njëjtë. Numri i udhëtarëve dhe beneficini në këtë biletë shkruhet me numra arab.

Formulari K-36 përdoret për evidentimin e biletave të shituara K-2a.

Biletat K-6

Bileta K-6 është biletë flet e cila përdoret nga:

a) Në stacione për pagesën e ndryshimit të çmimit të biletës :

- Me rastin e kalimit në klasën e parë
- Me rastin e kalimit në tren të rangut më të lartë
- Me rastin e zgjatjes së udhëtimit (destinacionit)

b) Konduktorët në tren e përdorin:

- Me rastin e kalimit në klasën e parë
- Me rastin e kalimit në tren të rangut më të lartë
- Me rastin e zgjatjes së udhëtimit (destinacionit)
- Me rastin e shmangies nga pagesa e biletës (aplikimi i gjobës)
- Me rastin e kompensimit të dëmeve të shkaktuar në tren
- Me rastin e marrjes së biletës nga revizorët e trenave

Bileta K-6 është formular strikt i vulosur dhe përbëhet prej dy fletëve:

- Amëza
- Biletë udhëtimi

Të dy fletët e mbajnë numrin e njëjtë. Secila biletari duhet ta ketë numrin rendor të vetë duke filluar prej 00001 deri në 10 000 të lidhura në bllok nga 100 copë dhe të vulosura me vulë të thatë (logo) të Trainkos Sh.A.

Amëza është me ngjyrë të bardhë ndërsa bileta e udhëtimit është me ngjyrë rozë.

Amëza shërben si bazë për llogaritje.

Biletë udhëtimi K-6 i jepet udhëtarit.

Bileta K-6 plotësohet në biletën amzë me laps kimik me ngjyre të kaltër ose të zezë por pa e futur indigon sepse bileta e udhëtimit përmban karbon, gjithmonë para se të plotësohet bileta duhet të vendoset një karton pas biletës së udhëtimit për arsye që shënimet mos të kalojnë në biletën tjetër. Plotësimi i biletave duhet të bëhet në mënyrë të qartë dhe të lexueshme, sipas rubrikave përkatëse në biletë, ndalohet fshirja dhe përmirësimi i shënimeve të shënuar në biletë. Me një biletë K-6 mund të kryhet pagesa deri në 6 udhëtarë të cilët udhëtojnë për një stacion destinues, bashkudhëtues në klasën dhe trenin e njëjtë pa marr parasysh se a shfrytëzojnë beneficione apo jo. Numri i udhëtarëve në këtë biletë shkruhet me shkronja.

Formulari K-52 përdoret për evidentimin e këtyre biletave.

Bileta K-8b

Janë bileta zonale me disa shënime që duhet të plotësohen me dorë dhe atë: numri i trenit, relacioni prej-deri, ndërsa data dhe muaji janë të shtypura anash të cilat duhet vetëm të fiksohen me rastin e dhënies së biletës.

Kjo biletë përdoret vetëm nga konduktorët në tren.

Bileta K-8b përbëhet prej këtyre zonave:

- Zona 1. 01-10 km ngjyrë e bardhë
- Zona 2. 11-20 km ngjyrë e verdhë
- Zona 3. 21-30 km ngjyrë e gjelbër
- Zona 4. 31-40 km ngjyrë roze
- Zona 5. 41-50 km ngjyrë e kaltër
- Zona 6. 51- 60 km ngjyrë e hirit
- Zona 7. 61-70 km ngjyrë kafe
- Zona 8. 71- 80 km ngjyrë e kuqe

Vërejtje: ngjyra e letrës e cila përdoret për këto bileta duhet të jetë e lehtë (çeltë).

Formulari K-53 përdoret për evidentimin e këtyre biletave.

Evidencën e rezervave dhe harxhimit të biletave e udhëheq Depoja e Trainkos, gjithashtu edhe konduktorët duhet të mbajnë evidencat për secilin lloj të biletave të cilët janë furnizuar në bazë të formularëve përkatës të biletave. Paratë e arkëtuara nga shitja e biletave duhet të dorëzohen së paku dy herë në javë tek arkëtari i Trainkos-it.

Neni 16.

Biletat e trenit për transport ndërkombëtarë

1. Për përcjellën e udhëtarëve në komunikacionin ndërkombëtarë përdoret bileta:

Bileta K-7 kjo biletë përdoret vetëm për transportin ndërkombëtar dhe përbëhet prej dy fletëve

- Amëza
- Biletë udhëtimi

Bileta K-7 lidhet në bllok prej 20 copë bileta me numër rendor prej 000001 deri në 999999 dhe të dy fletët e mbajnë numrin e njëjtë. Kjo biletë e rëndomtë përdoret vetëm për një udhëtarë. Mirëpo, kjo biletë jepet edhe në rast të udhëtimit në grup maksimumi për 5 udhëtarë të rritur dhe një fëmijë. Në rast të udhëtimit në grup në fushën “shënimet e posaçme” shënohet numri i udhëtarëve, shembull nëse udhëtojnë 3 të rritur dhe një fëmijë atëherë shënohet 3/1 persona.

Bileta K-7 plotësohet në biletën amzë me laps kimik me ngjyrë të kaltër ose të zezë por pa e futur indigon sepse bileta e udhëtimit përmban karbon, gjithmonë para se të plotësohet bileta duhet të vendoset një karton pas biletës së udhëtimit për arsye që shënimet mos të kalojnë në biletën tjetër. Këto jepen nga biletari në stacione dhe nga konduktori në tren. Kjo biletë plotësohet në formularin K-36m.

Aktualisht në komunikacionin ndërkombëtar përdoren biletat K-7 në relacionin H.Elezit – Shkup, furnizimi me këto bileta bëhet nga Hekurudhat Maqedone pasi që ne nuk jemi anëtar të UIC.

B) Pranimi dhe përcillja e udhëtarëve

Neni 17.

Objektet, hapësira, salla e pritjes, peroni

1. Hapësira është lokal themelor në stacion, i cili shërben për pranimin e udhëtarëve. Madhësia e tij varet prej frekuencës së udhëtarëve dhe në mënyrë funksionale është i lidhur me vendet e punës të stacionit, të cilat shërbejnë për pranimin – nisjen e udhëtarëve.

Në hapësirë duhet të qëndrojnë: informatat, biletaritë e udhëtarëve, salla e pritjes, lokali higjienik, këndet për shitjen e gazetave ditore, posta etj.

Në hapësirë duhet shënuar shenjat orientuese për lëvizjen e këmbësorëve dhe trenave. Shkrimet mund të jenë tekstuale ose me shenja (piktograme).

2. Sallat e pritjes mund të shfrytëzohen vetëm në bazë të biletës së vlefshme për udhëtim. Këto do të jenë të hapura sipas kushteve vendore, e më së voni në një orë para nisjes së trenit sipas orarit të lëvizjes së trenave. Në bazë të frekuencës dhe nevojës së udhëtarëve, sallat e pritjes mund të jenë të klasës së dytë (2) dhe të klasës së parë (1), sallat e pritjes për nxënës etj.

3. Peroni, është sipërfaqja përpara dhe ndërmjet vijave hekurudhore e cila është e destinuar për hyrjen e udhëtarëve në tren dhe dalje nga treni. Peronat duhet të jenë të shenjzuar me shenjat adekuate për drejtimin e udhëtarëve, të cilat tregojnë numrin e peronit. Peronat duhet të jenë të përshtatshme për lëvizjen e personave me aftësi të kufizuara. Qëndrimi i udhëtarëve në peron është i lejuar 60 minuta para ardhjes së trenit dhe 15 minuta pas shkuarjes së trenit.

Neni 18.

Mirëmbajtja e rendit dhe pastërtisë në trena

1. Vagonët e udhëtarëve në trena, gjithnjë duhet të mirëmbahen në gjendje të mirë dhe të pastër.
2. Mbikëqyrjen në aspektin e rendit dhe pastërtisë e bëjnë konduktorët, organet kontrolluese, si dhe punonjësit tjerë të cilët janë të angazhuar me detyrat e punës.
3. Për dëmtimet e shkaktuara në trena (vagonët e udhëtarëve) nga palët e treta, personi i autorizuar i Trainkos apo Konduktori e bën pagesën nga personi që ka kryer dëmtimet menjëherë në vend të ngjarjes. Pagesa bëhet me biletën K-6. Çmimorja për kompensimin e dëmeve duhet të jetë e vendosur në vagonë në vend të dukshëm. Në rast se personi i cili ka shkaktuar dëmet dhe nuk ka mjete për pagesën e këtij dëmi të njëjtit i merren shënimet e identitetit personal dhe në afat prej 15 ditëve, nëse nuk e bën pagesën e këtij dëmi atëherë, Trainkos do ta padis në gjykatën kompetente. Nëse personi i mitur udhëton bashkë me prindin (kujdestarin) dhe ka shkaktuar dëme në tren, atëherë kërkohet nga prindi (kujdestari) që të bëjë këtë kompensim të dëmit. Nëse prindi (kujdestari) refuzon të bëjë pagesën e këtij dëmi atëherë të njëjtit i merren shënimet e identitetit personal dhe në afat prej 15 ditëve, nëse nuk e bën pagesën e këtij dëmi, Trainkos do ta padis në gjykatën kompetente.

Neni 19.

Dhënia e biletave të trenit

1. Biletat e udhëtimit i japin biletaritë në stacione dhe vendqëndrime si dhe konduktorët në tren.
2. Biletat e udhëtimit jepen nga personi i autorizuar në stacione, si dhe mund të jepen edhe nga agjensionet e ndryshme në bazë të marrëveshjes.

3. Nëse kompania nuk ka mundësi që të organizoj dhënien e biletave nëpër vendqëndrime atëherë të njëjtat i japin konduktorët në tren.

4. Biletaritë e udhëtarëve duhet në vende të dukshme të ekspozojnë mbishkrimin “Sporteli i Biletave”. Nëse në një stacion ka më shumë sportele për dhënien e biletave atëherë të njëjtat duhet të shënohen me numër rendor për secilin sportel.

5. Biletaritë e udhëtarëve duhet të hapen me kohë varësisht nga frekuentimi i udhëtarëve, por më së voni 30 minuta para nisjes së trenit sipas orarit të lëvizjes së trenave. Sipas rrethanave, frekuentimit të udhëtarëve, shefi i stacionit me pëlqimin e kompanisë cakton biletaritë të cilat mund të jenë të hapura edhe para kohës së cekur më parë, respektivisht të cilat mund të jenë të hapura non-stop. Biletaria e cila punon non-stop duhet të ketë mbishkrim e “E hapur Non-Stop” Orari i punës për secilën biletari duhet të vendoset në vende të dukshme. Koha e paraparë për dhënien e biletave nuk guxon të shkurtohet as në rastet kur treni vonohet. Biletat e udhëtimit jepen edhe me parapagim për të gjithë trenat e udhëtarëve. Koha për dhënien e biletave me parapagim do të përcaktohet sipas tarifës së udhëtarëve.

6. Biletat e udhëtimit u jepen udhëtarëve sipas rendit ashtu siç kanë ardhur para sportelit. Përfshihen personat me aftësi të kufizuar, invalidë, nëna me fëmijë etj. Përparësi kanë edhe udhëtarët të cilët udhëtojnë me trenin i cili nis më herët se tjetri. Tek çdo sportel duhet të vendoset mbishkrimi hyrje-dalje dhe drejtimi i lëvizjes së udhëtarëve të shënuar me shigjetë. Biletaritë duhet dhënë bileta të udhëtimit derisa të ekziston mundësia që udhëtari të mund të hyjë në tren para nisjes së trenit.

7. Me frekuentimin më të madh të udhëtarëve (ditëve të tregut, panairëve, solemniteteve si dhe tubimeve) arka duhet të jetë e hapur edhe para kohës së paraparë, ku në këto raste shefi i stacionit merr masa që të gjithë udhëtarët të pajisen me bileta me kohë (ndihmë me arkëtarët të tjerë, hapje të arkave të tjera si ndihmë për furnizimin e udhëtarëve me bileta). Nëse biletaria në stacion për arsye të frekuencës së madhe të numrit të udhëtarëve nuk ka mundur t’i pajis të gjithë udhëtarët me bileta të udhëtimit të cilët kanë qenë pranë sportelit të biletarisë me qëllim të blerjes së biletave për trenin përkatës, në qoftë se arka nuk ka qenë e hapur me kohë, qoftë edhe frekuentimi i madh i udhëtarëve ose ndonjë arsye tjetër për të cilën nuk ka qenë faji i udhëtarëve, biletari është i detyruar që të njoftojë udhëtarët se biletat e udhëtimit mund të merren tek konduktori në tren pa pagesë shtesë. Drejtuesi i trenave është i obliguar që në fletë-udhëtimit e trenit përkatës në këtë rast të shënoj (udhëtarët udhëzohen që të hyjnë në tren pa bileta udhëtimit, që pagesat e biletave të bëhen në tren) lidhur me këtë njëherit i njofton edhe konduktorët në tren. Konduktorët e bëjnë pagesën e biletave për këta udhëtarë pa pagesa shtesë ku në rubrikën e biletës K6 (Vërejtje) shënojnë (pika në Udhëzimin mbi TU). Lidhur me këtë biletari duhet të njoftoj shefin e biletarisë i cili është i obliguar që çdo rast të tillë menjëherë të hetoj dhe me shkrim të njoftoj kompaninë me përshkrimin detal të arsyes për të cilën udhëtarët janë drejtuar në tren pa bileta të udhëtimit.

8. Biletari duhet të jetë njohës i mirë i rendit të udhëtimit të trenave për të mundur t'i njoftoj udhëtarët dhe të jap sqarime të nevojshme.

9. Nëse në stacion ekziston byro informative biletari do të jep njoftime vetëm atëherë nëse me këtë nuk e pengon dhënien e biletave. Nëse udhëtari kërkon biletën udhëtimi për stacionin në të cilin treni përkatës nuk ndalet, biletari është i obliguar që të tërhiqet vërejtjen. Biletari nuk mund të plotëson kërkesën e udhëtarit që të jep biletën e udhëtimit për klasën e parë ose lloj më të lartë të trenit nëse në orar të udhëtimit nuk është e paraparë.

10. Nëse udhëtari kërkon që një pjesë të relacionit do ta shfrytëzoj me klasën e parë, nga stacioni i nisjes deri në stacionin e destinuar duhet të jepet bileta e klasës së dytë, ndërsa për relacionin që do të shfrytëzoj me klasën e parë duhet t'i jepet bileta K6 në të cilën do të llogaritet ndryshimi në mes të klasës së dytë dhe klasës së parë.

11. Me rastin e përcjelljes së udhëtarëve me bileta me shënime të shtypura, biletat e udhëtimit duhet t'i jepen secilit udhëtar veç e veç. Nuk është e lejuar përcjellja e udhëtarëve dhe dhënia e shumë biletave për një udhëtar, ose një biletë për shumë udhëtarë me shënime të shtypura, si dhe dy bileta me beneficion 50% në vend të një bilete me çmim të rregullt. Mënyra e drejt e dhënies së biletave me shënime të shtypura është e domosdoshme së pari për udhëtarë, për arsye të kontrollës së biletave të udhëtimit dhe evidencave mbi dhënien e biletave (si dhe km/udhëtar).

12. Bileta e udhëtimit duhet të jepet direkt nga stacioni i nisjes deri në stacionin e destinuar për trenin dhe klasën përkatëse, rrugën kaluese sipas kërkesës së udhëtarit, nëse ajo është e mundur.

13. Nëse në disa stacione biletat e udhëtimit jepen me orar të kufizuar (në kohë dhe në trena të caktuar) kjo duhet të lajmërohet në udhëzimin e orarit të lëvizjes së trenave si dhe me njoftim para biletarisë (shkaku i kohës së kufizuar).

14. Në stacionet të cilat gjenden në mes të dy stacioneve kufitare përcjellja e udhëtarëve në stacionin ndërkombëtarë mund të bëhet vetëm nëse është e mundur kontrolla e doganës dhe organeve kufitare dhe nëse organet përkatëse shtetërore e lejojnë këtë udhëtim.

15. Me rastin e dhënies së biletave me beneficion biletari është i obliguar që të vërtetoj saktësinë e bazës për beneficionin përkatës (libreza, bexhat, ID kartelat, vërtetimet etj.). Nëse numri i udhëtimeve është i kufizuar, me vulë, stacionet duhet të anulojnë udhëtimin në rubrikën përkatëse.

16. Biletat duhet të jenë të shtypura në letër cilësore dhe të përmbajnë elemente të sigurisë

Neni 20.
Vulosja e biletave të trenit

1. Me rastin e dhënies së biletave të udhëtimit biletaria vepron në këtë mënyrë:

Vulosë secilën biletë me vulë të stacionit me datë për secilën biletë veç e veç. Para fillimit të dhënies së biletave, biletari është i obliguar që të vërtetoj se a është ndërruar data e vulës për ditën përkatëse dhe të njëjtën e provon në një fletë të bardhë se a është në rregull data.

2. Vula e stacionit me datë duhet t'i ketë shënimet e duhura për ditën, muajin dhe vitin. Dita dhe muaji shënohen me nga dy numra arab ndërsa viti me numra të plotë p.sh. 01.01.2013. Nëse bileta e udhëtimit jepet me parapagim ajo vuloset me vulën e stacionit me datën kur është dhënë, ndërsa si ditë e parë e vlefshmërisë (shfrytëzimit) shënohet në rubrikë përkatëse.

3. Çdo biletari e stacionit, agjension i udhëtarëve duhet të ketë vulën e stacionit me datë e cila përveç shënimeve të cekura më lartë duhet të ketë emrin e stacionit, ose agjensionit, dhe numrin e biletarisë përkatëse, shembull: Elemente që duhet t'i përmbaj vula janë : Emri i stacionit, Data (dita, muaji,viti) dhe numri i biletarisë. Vula duhet të ruhet në vend të sigurt dhe të përdoret vetëm nga personat të cilët janë të autorizuar.

4. Nuk është e lejuar dhënia e biletave të cilat nuk janë të vulosura. Biletat e trenit të cilat janë të parregullta janë: biletat që kanë shënimet të pa sakta, të vulosura dy herë. Këto bileta konsiderohen si bileta "gabimisht të vulosura".

5. Nëse biletari e ka vulosur gabimisht një biletë atëherë të njëjtën duhet që me laps kimik ta anuloj duke tërheq vizën në nga dy këndet e biletës në formë të X dhe të vuloset me vulën e stacionit me datë dhe të nënshkruhet nga biletari. Në rastet të veçanta biletat mujore të nxënësve dhe të punëtorëve duhet të vulosen me vulën e stacionit edhe në anën e pasme të biletës.

Neni 21.
Pagesa e çmimit të udhëtimit (transportit)

1. Pagesa e biletës së udhëtimit bëhet me valutën Euro.

Neni 22
Benificionet e udhëtimit - mënyra e përdorimit

- a) benificionet ligjore
- b) benificionet komerciale
- c) benificionet tjera
- a) Benificionet ligjore

1. Familjet e Dëshmorëve, Veteranët dhe Invalidët e Luftës së UÇK-së

Në këtë kategori bëjnë pjesë:

- Familjarët e afërt të dëshmorëve dhe martirëve të luftës (këtu përfshihen prindërit, bashkëshorti/ja dhe fëmijët)
- Invalidët e luftës së UÇK-së;
- Veteranët e luftës së UÇK-së;

Kjo kategori mund të lirohet vetëm në rastet kur kjo dëshmohet me anë të librezave adekuate të lëshuara nga shoqatat e dala nga lufta e UÇK-së dhe atë të ripërtërira sipas rregullave të përcaktuara nga organizatat.

- Fëmijët nën moshën 4 vjeçare të cilët nuk zënë ulëse të veçantë (ulën në prehrin e shoqëruesit);
- Punëtorë e Hekurudhave të Kosovës-Trainkos Sh.A. në ardhje/shkuarje në /nga puna;

Shtirirja e përfitimit për këto kategori do të jetë në lartësinë e totalit të pagesës së biletës, respektivisht transporti do të jetë pa pagesë në shkuarje dhe kthim.

2. Invalidët

Varësisht, nga ligjet përkatëse të nxjerra në vendin tonë, personat që mund të përfitojnë nga ky benificion, janë:

- Të verbrit që kanë aftësi të kufizuar të pamurit, sipas ligjeve në fuqi;
- Shurdhë memecët;
- Personat e retarduar mentalisht rëndë;
- Të hendikepuarit me dëmtimin e organeve për lëvizje e të paktën 70 %;
- Të sëmurit kronikë renal me hemodializë;
- Personat të cilët në përputhje me rregulloret e veçanta i njihet e drejta për kujdesin dhe ndihmën e një personi tjetër;

- Invalidët e punës.
- Fëmijët me aftësi të kufizuara, prindërit e të cilëve kanë të drejtë pune me kohë të pjesshme për tu kujdesur për një fëmijë me të meta serioze.

Shtirja e përfitimit për këto kategori do të jetë 50% e totalit të pagesës së biletës, nëse ofrohen dëshmi valide që personi i përket njërës prej kategorive të lartcekura

b) Benificionet Komerciale

Benificionet komerciale, janë benificione të cilat i miraton menaxhmenti i HK Trainkos Sh.A.

Në këtë kategori bëjnë pjesë:

- Nxënësit dhe studentët e rregullt;

1. Nxënësi, për përfitimin e benificionit, duhet të tregoj Kartën e Identitetit (ID) të nxënësit me rastin e marrjes së biletës. Në rast të mungesës së ID-së, atëherë nxënësi nuk mund të përfitoj këtë benificion.

2. Ndërsa, studentët duhet të nxjerrin Kartën e Identitetit të lëshuar nga HK Trainkos Sh.A. e cila nxjerrët në administratën qendrore të Trainkos Sh.A. duke dëshmuar statusin e vet, me dokumentin e studentit dhe me një vërtetim të lëshuar nga fakulteti përkatës. ID-Kartela ka vlefshmëri, një vit akademik.

Në rast të mungesës së ID-kartelës, atëherë studenti nuk mund të përfitoj këtë benificion.

Lartësia e shtrirjes së benificionit për këto kategori (1,2), do të jetë zbritje 50% e çmimit të rregullt të biletës.

- Pensionistët;

Këtu përfshihen të gjithë personat që kanë moshën mbi 65 vjeçare. Kjo dëshmohet përmes dokumenteve të identifikimit, me rastin e udhëtimit.

Shtirja e përfitimit për këto kategori do të jetë zbritje 50% e çmimit të rregullt të biletës.

- Organizimi i udhëtimeve grupore;

Shfrytëzimin e këtij benificioni mund ta bëjnë të gjithë ato grupe që janë në numër mbi 5 persona në të njëjtin destinacion. Lartësia e benificionit do të jetë 20 % e çmimit të rregullt të biletës, për secilin person.

Në rast se grupi ka nga 20-40 persona dhe lajmërohet 48 orë përpara nisjes, atëherë pos beneficionit prej 20 %, njëri nga udhëtarët gëzon të drejtën e udhëtimit pa pagesë. Për më shumë se 41 udhëtarë, këtë të drejtë e gëzojnë dy persona.

- **Udhëtimet kthyesë me zbritje pa kushte të veçanta 20 %;**

Të gjithë udhëtarët, të cilët blejnë biletë kthyesë brenda 24 orëve, atëherë udhëtarët në fjalë gëzojnë beneficionin prej 20 % të çmimit të rregullt të biletës.

- **Udhëtimet e gazetarëve;**

Të gjithë gazetarët të cilët udhëtojnë në vizita zyrtare, e të cilët kanë kartelë të anëtarësimi në organizatën e gazetarëve të Kosovës, përfitojnë beneficion në lartësi 20 %.

- **Vikend bileta**

Vikend bileta, jepet me bileta K-2a, që mund të shfrytëzohet nga të gjithë udhëtarët të cilët nuk përfitojnë beneficione tjera. Kjo biletë mund të shfrytëzohet brenda një vikendi në shkuarje dhe kthim. Lartësia e beneficionit do të jetë në lartësinë 30 % të biletës së rregullt për shkuarje dhe kthim.

c) Beneficionet e tjera

Në këtë kategori bëjnë pjesë:

- **Punëtorët e Hekurudhave të Kosovës-Trainkos**

Të gjithë punëtorët që janë të angazhuar me punë të rregullt në Hekurudhat e Kosovës-Trainkos, gëzojnë të drejtën e udhëtimit pa pagesë me tren. Të njëjtit me rastin e ardhjes së biletarit, duhet të tregojnë kartelën e të punësuarit e cila merret në kompaninë e tyre.

- **Kategori që mund të përfitojnë nga vendime të veçanta të menaxhmentit.**

Menaxhmenti, varësisht nga rrethanat dhe marrëveshjet e ndryshme që mund të arrijë në të ardhmen, mund të jap mundësi të përkohshme apo me vendim të Bordit të Drejtorëve më mundësi të përhershme, t'i benificoj edhe kategoritë tjera.

Neni 23.
Kërkesa për vagonë dhe tren të posaçëm

a) Vagon i veçantë

- Si vagon i veçantë, konsiderohet vagoni i cili vendoset në tren me kërkesën e palës për nevojat e tyre.
- Kërkesën për vagon të veçantë të udhëtarëve e merr stacioni fillestar dhe ia dërgon menjëherë sektorit të Transportit të Udhëtarëve.
- Përcjellja bëhet me biletë të udhëtimit K-2a.
- Në vagonët e veçantë, vendoset njoftimi në dyer apo në dritare "E REZERVUAR"
- Pagesa e këtij vagoni do të jetë në lartësinë e pagesës së numrit të ulëseve me beneficion 20 % dhe dy udhëtarë do udhëtojnë pa pagesë.

b) Treni i veçantë me kërkesë të personave juridik

- Treni i veçantë mund të vendoset në komunikacion me lejen e Trainkos Sh.A.
- Nëse gjatë rrugës paraqiten ndryshime tjera, të cilat ndikojnë në çmimin e transportit (përbërja e trenit, ndalja e trenit, etj.), në pjesën e prapme të biletës K-2a, duhet të shënohen ndryshimet e bëra dhe të vërtetohen.

c) Vendosja dhe transporti i udhëtarëve.

Neni 24
Hyrja në vagon dhe akomodimi i udhëtarëve

1. Derisa treni të përgatitet për nisje, në tren mund të hyjnë edhe persona tjerë të cilët i ndihmojnë udhëtarët për t'u vendosur.

- Treni është i gatshëm për nisje, në momentin kur konduktori jep shenjë në bazë të shenjës së përcjellësit të trenave, i cili i fton udhëtarët të hynë në vagon.
- Pas shenjës për nisje, nuk mund të hyjë e as të dal askush nga vagoni.

2. Udhëtari, sipas dëshirës, mund të marrë një vend të lirë në klasën për të cilën e ka biletën e udhëtimit. Nëse atë nuk e bënë, atëherë mund të kërkoj nga konduktori që të ia caktoj një ulëse të lirë në tren, nëse kjo është e mundshme.

- Nëse në mes të udhëtarëve lind mosmarrëveshje për vendin e ulëses, atëherë konduktori është i detyruar që çdo udhëtar të ia caktoj vendin përkatës për ulje, në atë apo në vagonin tjetër, nëse ka vende të lira.
- Në trenat ku bëhet rezervimi i ulëseve, udhëtarë mund të vendoset vetëm në vagonin dhe ulësen për të cilën ka siguruar rezervimin përkatës.

3. Udhëtarë dhe shoqërues të cilën e ka autorizuar udhëtarë, mund të shënojnë ulëset e lira për vete dhe për shoqëruesin, me të cilën udhëton bashkë dhe duhet të tregoj biletën e udhëtimit për vete dhe shoqëruesin.

- Shënimin e vendit për ulje, udhëtarë mund të vendos çanta, libra, apo gjësende tjera personale, vendosjen e bagazhit të dorës në raft lartë, apo nën ulëse, si shenjë se ulësja është e zënë, tërheqja e vërejtjes së udhëtarëve se ulësja është e zënë.
- Nëse udhëtarë, e ka lëshuar ulësen, por nuk e ka shënuar sipas mënyrave të cekura më lart, atëherë humb të drejtën që përsëri ta merr këtë ulëse, nëse ajo është e zënë nga ndonjë udhëtarë tjetër.
- Në rast mosmarrëveshje mes udhëtarëve për ulëset, konduktori vërteton se a ka qenë ulësja e shënuar apo jo sipas dispozitave të lartcekura. Apo gjen ndonjë alternativë për të dy palët, e cila është obligative për tu respektuar.

4. Të gjithë udhëtarët, duhet të shfrytëzojnë ulëset përkatëse varësisht nga bileta e udhëtimit që kanë nxjerrë.

- Nëse në një vagon, ka zënë ulëse një udhëtarë që akoma nuk ka nxjerrë biletën e udhëtimit, ndërsa udhëtarët që paraprakisht kanë nxjerrë bileta por akoma nuk kanë mundur të zënë vend më parë, konduktori do të caktoj që udhëtarë pa biletë të udhëtimit, të ia liroj vendin udhëtarit që paraprakisht ka nxjerrë biletë të udhëtimit. Pastaj, udhëtarë që akoma s'ka nxjerrë biletën, duhet të merr biletën te konduktori.
- Kjo nuk vlen atëherë kur udhëtarët nisen nga vendet ku nuk ka pasur mundësi të pajisen me biletë para hyrjes në tren.

5. Me rastin e hyrjes në tren si dhe vendosjes së udhëtarëve në ulëset përkatëse, duhet të kenë parasysh:

- Që udhëtarët të cilët udhëtojnë më një biletë të përbashkët të udhëtimit, të vendosen në të njëjtin vagon, dhe mundësisht pran njëri tjetrit.
- Udhëtarë me kafshë shtëpiake më të cilat lejohet hyrja e tyre në tren, në bazë të nenit 25 të Rregullores mbi Organizimin e Transportit të Udhëtarëve, duhet të vendoset në fund të vagonit ose sipas mundësive të jetë ndaras nga udhëtarët e tjerë dhe të jetë në vagonin e fundit.

- Udhëtari me rroba të përlyera, nga të cilat mund të përlyhen ulëset dhe udhëtarët tjerë, sipas mundësive të vendosen ndaras nga udhëtarët tjerë.
- Personat e lënduar rëndë, të sëmurë rëndë, të palëvizshëm, të cilët për shkak të barelës, sipas mundësive të vendosen ndaras nga udhëtarët tjerë apo në një vagon të posaçëm.
- Në tren, nëpër të gjithë vagonët është e ndaluar pirja e duhanit, sipas Ligjit për Kontrollin e Duhanit 2012/04-L-156 që është i aplikueshëm në Kosovë.
- Nëse udhëtarët e pinë duhanin, atëherë konduktori është i obliguar të ia tërheqë vërejtjen. Nëse, prapë udhëtari vazhdon me pirjen e duhanit, atëherë konduktori është i obliguar të njoftoj institucionin përkatës, siç edhe parashihet më Ligjin për Kontrollin e Duhanit.

Neni 25

Personat të cilët largohen nga transporti ose barten me kusht

- Udhëtarët të cilët janë të infektuar (apo dyshohet se janë të infektuar) nga sëmundjet ngjitëse, nuk guxojnë të udhëtojnë me tren.
- Udhëtarët tek të cilët, gjatë kohës së udhëtimit, lajmërohen shenjat e ndonjë sëmundje ngjitëse, konduktori duhet menjëherë t'i vendos në vend të mbyllur dhe rastin ta lajmëroj te shefi i stacionit apo përcjellësi i trenave në stacionin e parë ku ndalet treni.
- Konduktori duhet që në stacion, Shefit të Stacionit të ia dorëzoj regjistrin e të gjithë udhëtarëve që kanë udhëtuar me personin e sëmurë apo që dyshohet që është i sëmurë.
- Regjistri duhet të përmbaj: Emrin e Mbiemrin, vendin e banimit dhe vendin ku udhëton.
- Shefi i Stacionit, është i detyruar që vagonin më të cilin kanë udhëtuar personat e sëmurë, përkohësisht të largohen nga treni dhe ta bëj dezinfektimin, sipas udhëzimeve të organit sanitar përgjegjës.
- Për vagonin më të cilin kanë udhëtuar njerëzit e sëmurë dhe ka qenë e nevojshme të bëhet dezinfektimi, nuk paguhet pagesa për dezinfektimin e kryer nga udhëtari.
- Personat të cilat janë të infektuar nga sëmundjet ngjitëse, mund të udhëtojnë më tren vetëm në hapësirat e mbyllura, në WC të posaçme dhe duhet të kenë përcjellës.
- Kontrollin e biletës për personin e sëmurë dhe përcjellësin e tij, konduktori duhet ta bëj në stacionet fillestare, para se të hyj në tren.

Neni 26

Bartja e gjallesave në vagonë të udhëtarëve

- Kafshët e gjalla, nuk guxon të vendosen në vagonë të udhëtarëve, nëse nuk është në kundërshtim më udhëzimet sanitare të veterinarisë apo udhëzimeve tjera, atëherë mund të vendosen në vagonë të udhëtarëve, të vendosur në kafaz, shporta apo mbështjellës të posaçëm.

- Qenët e vegjël, mund të vendosen në vagonë të udhëtarëve edhe nëse nuk janë të mbyllur në kafaz, me kusht që në vagon të mbahen në krahë dhe të jenë të furnizuar më shporta në gojë, të cilat e pengojnë kafshimin eventual të udhëtarëve tjerë.
- Policia, FSK-ja apo KFOR-I, gjuetarët, njerëzit e verbër të cilët shoqërohen nga qenët e mëdhenj mund të vendosen në vagon vetëm atëherë kur nuk kundërshton asnjë udhëtarë.
- Udhëtarët të cilët janë të shoqëruar nga qentë e mëdhenj, merren në tren nëse ka vagonë të posaçëm për vendosjen e kafshëve.
- Qentë të cilët transportohen me hekurudha, pa marrë parasysh madhësinë e tyre, në hundë duhet të kenë shportën mbrojtëse.
- Gjallesat të cilat janë në kundërshtim më rregullat e përcaktuara, vendosen në vagon të udhëtarëve, duhet që të largohen nga vagoni.

Neni 27

Udhëtimi pa biletë të rregulltë në tren

- Çdo person që udhëton me tren, duhet të ketë sipas rregullave biletën valide të udhëtimit, sipas dispozitave të këtij udhëzimi.
- Biletë të udhëtimit duhet të kenë të gjithë udhëtarët, me përjashtim të atyre që janë të liruar sipas nenit 22 të këtij udhëzimi.

Neni 28

Detyrat e Konduktorit

1. Konduktori është i obliguar që në stacionin e nisjes së trenit të lajmërohet me kohë, rregullisht i furnizuar me pajisjet e nevojshme për kryerjen e detyrës dhe fizikisht i pushuar.

- Konduktori, duhet të lajmërohet para nisjes së trenit, së paku 30 min, kur edhe duhet të lajmërohet tek Drejtuesi i Trenave.

2. Pasi që Drejtuesi i Trenave ka vërtetuar se konduktori është i aftë për të marrë detyrën zyrtare dhe pasi që i janë caktuar vagonët për shërbim, konduktori është i obliguar që deri në vendosjen e vagonëve për hyrjen e udhëtarëve t'i kontrolloi dhe të raportoi tek kontrolluesi i vagonëve lidhur me gjendjen e vagonëve.

- Konduktori, më ketë rast, duhet të kontrolloi gjendjen e frenit të dorës, pajisjet lidhëse dhe:
 - A janë vagonët të pastër nga brenda dhe jashtë si dhe a janë të ajrosur;
 - Pajisjet për ngrohej dhe ndriçim, a janë në gjendje të rregullt;

- Gjatë sezonit së dimrit, vagonët a ofrojnë ngrohje sipas standardeve;
- A janë rezervuarët dhe enët për ujë, të mbushura më ujë të mjaftueshëm;
- A janë në gjendje të rregulltë pajisjet sanitare dhe a ka në sasi të mjaftueshme letër tualeti dhe sapun për pastrimin e duarve;
- A janë shkallët, kalesat dhe platformat, kur është koha e ngricave, të kripura më rërë dhe pajisje tjera, kundër krijimit të akullit;
- A mbyllen mirë dyert dhe dritaret;
- A janë të vendosura tabelat sinjalizuese në vagonë;

Detyrat e konduktorit në aspektin e mirëmbajtjes së garniturave (ngrohja, ndriçimi, uji) si dhe veprimet me pajisjet tjera nga: stacioni i nisjes, gjatë kohës së udhëtimit si dhe në stacionin e fundit, janë të parapara më udhëzimin nr. 40 "Udhëzimi i Komunikacionit".

Këto rregulla konduktori duhet t'i njohë mirë dhe t'i aplikojë, pasi që nga këto varet edhe komoditeti i udhëtimit.

3. Më qëllim të eliminimit të mungesave dhe parregullsive të konstatuara më rastin e kontrollit të vagonëve të cilat mund të eliminohen deri në kohën e nisjes së trenit, konduktori do të ndërmarrë masa adekuate për eliminimin e parregullsive dhe mangësive. Nëse ka parregullsi apo mangësi që nuk mund t'i eliminoi deri në kohën e nisjes së trenit, vërejtjet e pa eliminuara, konduktori do t'i shënoj në raportin K-91 dhe do të ia dërgoi kontrolluesit të vagonëve.

- Për mungesat dhe parregullsitë teknike, të cilat vërehen në vagona gjatë udhëtimit të trenit, konduktori do të përpiloj raportin në stacionin e fundit të trenit.

4. Kur treni është i vendosur në Stacionin e nisjes për hyrjen e udhëtarëve, konduktori duhet të jetë në fillim të vagonëve të cilët i janë caktuar për shërbim, më qëllim të orientimit të udhëtarëve nëpër vagonët përkatës, të jap informatat e kërkuara në mënyrë të drejtë dhe të qartë, t'i ofroi ndihmë të drejtpërdrejtë personave me nevojë.

- Gjithashtu, duhet të ketë kujdes që udhëtarët mos të sjellin në tren gjësende të cilat nuk konsiderohen si bagazh.

5. Në shenjën e drejtuesit të trenave, "Në vend", konduktori i thërret udhëtarët që të hyn dhe t'i zënë vendet në vagonë dhe pas hyrjes së udhëtarëve t'i mbyllë dyert në të gjithë vagonët dhe të jep shenjat e nevojshme të parapara sipas rregullores Nr. 1 "Rregullorja e shenjzimit".

6. Me daljen e trenit nga stacioni, pasi që paraprakisht janë kontrolluar kalesat dhe shkallët në të dy anët e trenit që eventualisht mos të ketë udhëtarë në to, konduktori i thërret udhëtarët që të zënë vendet dhe fillon kontrollin e biletave të udhëtimit.

- Para se konduktori të hyn në hapësirën e transportit të udhëtarëve, për kontrollin e biletave të udhëtimit, konduktori është i obliguar që në mënyrë të drejtë dhe të thjeshtë (sipas kohës së ditës) t'i përshëndet udhëtarët dhe t'i lus për kontroll të biletave me shprehjen "Ju lutem përgatiteni biletat për kontroll".

7. Përkundër asaj që udhëtari është i obliguar që vet të kujdeset që në stacionin e nisjes dhe stacionin bashkangjites (ndërrim treni) të hyj në trenin që i nevojitet për udhëtim, si dhe të dal nga treni në stacionin që e ka destinacion. Gjatë kontrollit të biletave konduktori duhet ta informoj për kalim në stacionin bashkangjites (ndërrim treni) dhe më kërkesë të udhëtarit, të jap informata tjera (me kohën e arritjes së trenit në stacionin e fundit, kohën e qëndrimit të trenit në disa stacione, për lidhjet me trena tjera si dhe vonesat eventuale).

8. Pas përfundimit të kontrollit të biletave, konduktori është i obliguar që vazhdimisht të kujdeset për mbajtjen e rendit në pjesën e trenit për të cilën është i ngarkuar. Që d.m.th, për vendosjen e udhëtarëve në vendet përkatëse, për mënyrën e shfrytëzimit të ulëseve dhe hapësirës për vendosjen e bagazheve, për vendosjen e bagazheve të dorës, për hapjen dhe mbylljen e dritareve dhe dyerve, për shfrytëzimin e ndriçimit dhe pajisjeve të ngrohjes, për qëndrimin e udhëtarëve në korridore dhe platformë, për shfrytëzimin e hapësirave ndihmëse e të tjera. Që të jetë në shërbim të qytetarëve, konduktori duhet shpesh, të kaloj nëpër pjesën për të cilën është i ngarkuar.

- Nëse vagoni apo pjesa e trenit, për të cilin është i ngarkuar konduktori përlyhet me vjellje, gjakderdhje apo të ngjashme, konduktori është i obliguar, nëse në tren nuk është pastruesi, që për këtë ta lajmëroj përcjellësin e trenave në stacionin e parë të ardhshëm, të cilët duhet të marrin masa për pastrimin e vagonit, apo pjesën e trenit e cila është përlyer.
- Në rast nevojë, nëse intervenimi i tij, nuk ka pasur ndikim te personat që e prishin rendin, konduktori duhet të kërkoj ndihmë nga përcjellësi i trenit apo policia.

9. Konduktori është i obliguar, posaçërisht natën dhe në stacionet ku i bashkëngjitet edhe ndonjë vagonë, në të cilat treni do të ndalet për kohë të shkurtër, që në tren para arritjes së tij në stacion, t'i njoftoj udhëtarët që të përgatiten për dalje, gjegjësisht për kalimin në trenin tjetër.

- Me arritjen e trenit në stacion, konduktori është i detyruar të i hap dyert e atyre vagonëve nga të cilët udhëtarët dëshirojnë të zbresin dhe para çdo vagoni që është i ngarkuar të shërbej, duhet më zë të lartë ta thotë emrin e stacionit, eventualisht ndërrimin e vagonit, kohën e qëndrimit në stacionin ndarës (bashkangjites), nëse qëndrimi është më i gjatë se 4 minuta. Përveç kësaj, jep informata për lidhjet, kalimin në trena për relacionet përkatëse, e në stacionin kufitar edhe për kontrollin doganor. Në rast të vonesës së trenit, duhet të lajmëroj vonesën eventuale, qëndrimin e trenit, sipas orarit të udhëtimit, për çka është i obliguar të lajmëroj përmes konduktorit fqinjë (në vagonët e afërt), përmes

përcjellësit të trenave, nëse ky këtë nuk e bënë, të te gjithë konduktorët e tjerë, përmes konduktorit të parë.

10. Gjatë kohës së udhëtimit, konduktori nuk guxon të ulet më udhëtarët dhe në vagonët në të cilët nuk shërben. Takimi më konduktorët e tjerë, lejohet vetëm nëse këtë e kërkon shërbimi.

11. Nëse udhëtarët nuk mundën të merren vesh në aspektin e hapjes dhe mbylljes së dritareve, dyerve apo pajisjeve për ajrosje, për errësimin e dritareve (vendosjen e perdeve), për përdorimin e pajisjeve për ngrohje e të ngjashme, në këtë rast vendos vet konduktori.

- Sipas rregullave, dritaret dhe dyert mund të jenë në të njëjtën kohë të hapura në të dy anët e vagonit vetëm me pëlqimin e të gjithë udhëtarëve.
- Konduktori duhet të intervenoj vetëm atëherë kur të bindet se marrëveshja në mes të udhëtarëve nuk është e mundur apo kur mosmarrëveshja mund të shkaktoj prishjen dhe rendin e qetësisë në tren. Gjatë zgjedhjes së mosmarrëveshjes, konduktori duhet që përveç tjerash në mënyrë të drejtë t'i përdor mjetet e nevojshme në mënyrë të drejtë. Duhet të ketë qëndrim korrekt dhe të kulturuar.

12. Nëse në tren ndodh vjedhja dhe këtë udhëtari e paraqet te konduktori, duhet të thirret edhe policia.

- Nëse në tren vidhet bagazhi i dorës, konduktori mundet me leje të sigurimit të trenit, që të bëjë kontrollimin e trenit, në prezencën e udhëtarit që i ka humbur bagazhi.
- Për rastin duhet të lajmërohet stacioni i parë në të cilin ndalet treni. Nëse kjo për shkak të kohës së shkurt nuk mund të kryhet (kontrollimi), duhet ta lajmëroj stacionin e parë të ardhshëm, më qëllim të ndërmarrjes së masave të organi përkatës më qëllim të hetimit të mëtejshëm të rastit. Në këtë stacion, konduktori e dorëzon raportin K-91. Stacioni amë, të cilit konduktori i dorëzon amëzën e raportit K-91 për rastin e raportuar është stacioni në Fushë Kosovë.

13. Detyrat tjera të konduktorit të cilat i përkasin shërbimit të komunikacionit, reklamimet dhe kërkesat, veprimet doganore si dhe veprimet me gjësendet e gjetura, këtu vlejné dispozitat përkatëse të udhëzimeve dhe të rregulloreve përkatëse.

14. Konduktori është i obliguar që organit kontrollues të hekurudhës, para fillimit të kontrollit përkatës në tren, gojarisht ta informoi për gjendjen në pjesën e trenit nën mbikëqyrjen e tij.

15. Konduktorit i ndalohet pirja e duhanit dhe pijeve alkoolike në tren.

Neni 29

Kontrollimi i biletave të udhëtimit në tren

1. Biletat e udhëtimit në tren për transportin e udhëtarëve i kontrollon konduktori.

- Për çdo tren duhet të caktohet numër i mjaftueshëm i konduktorëve, në mënyrë që kontrollimi i biletave të kryhet në kohë sa më të shkurt. Numri i konduktorëve varet nga: frekuentimi i udhëtarëve, lloji i trenit, lloji i vagonit dhe kushtet specifike në disa linja hekurudhore. Gjatë kësaj, duhet pasur kujdes se konduktori krahas kontrollit të biletave ka edhe detyra tjera në lidhje me akomodimin dhe transportin e sigurt të udhëtarëve, si dhe kujdesin dhe përgjegjësinë nga Neni 28 i këtij udhëzimi.
- Për shërbim, një konduktori mund t'i shpërndahen më së shumti 3 vagonë katër boshtor, gjegjësisht 4 vagonë dy boshtër.

2. Shikimin e përgjithshëm të biletave të udhëtimit, konduktori duhet ta filloj menjëherë pas daljes së trenit nga stacioni i nisjes. Gjegjësisht, nga stacioni ku e merr detyrën.

- Në stacionet kufitare, të trenat e natës, shikimi i biletave të udhëtimit sipas mundësive duhet të filloj menjëherë pas kontrollimit të doganierëve dhe policisë kufitare, për mos t'i shqetësuar udhëtarët më vonë.

3. Gjatë shikimit të biletave të udhëtimit, konduktori verifikon:

- A i ka kaluar biletës afati i vlefshmërisë (kontrollon gjurmët e vulës, datën e vlefshmërisë së biletës dhe numrin e trenit).
- A vlen bileta për relacionin përkatës, për llojin e trenit dhe klasën.
- A ka udhëtari bazë për shfrytëzimin e beneficionit të udhëtimit, korrektësia e kësaj baze, beneficioni i shkruar në biletë a i përgjigjet beneficionit të lejuar, a i ka kaluar afati i përdorimit, a është e vulosur me vulë dhe nënshkrimi.
- Konduktori është i obliguar të jetë i vëmendshëm që bileta e udhëtimit, ose baza e beneficionit të mos jenë eventualisht të falsifikuara, apo të keqpërdorura në një mënyrë tjetër.
- Konduktori nuk guxon që sipërfaqësisht t'i kontrollojë biletat apo vetë, të pranojë deklarata të udhëtarëve që kanë biletë udhëtimi, por duhet gjithmonë të kontrollojë çdo biletë si dhe bazën e beneficionit dhe të vërtetojë a janë valide.

4. Pasi që ka vërtetuar rregullsinë e biletës si dhe bazën e beneficionit, atëherë konduktori është i obliguar që pas verifikimit, nga bileta të grisë këndin e epërm të djathtë të biletës së udhëtimit.

5. Në komunikacionin ndërkombëtarë, me rastin e çdo kontrolli, konduktori duhet që në anën e pasme të biletës të shënoj numrin e trenit, datën dhe stacionin e parë ku sipas rendit të udhëtimit ndalet treni, që d.m.th se ajo biletë është shfrytëzuar deri në atë stacion.

6. Nëse udhëtari posedon biletën e pavulosur apo të vulosur më datë të gabuar, konduktori do të anulohet dhe do të marrë nga udhëtari biletën, para arritjes së trenit në stacionin destinues. Lidhur më këtë, konduktori raporton më K-9, stacionit amë i cili pastaj do të raportoj te kompania. Në K-91, duhet të shënohen shënimet personale dhe adresa e udhëtarit të cilit i është marr biletë e cila duhet t'i bashkëngjitet raportit si dëshmi.

7. Si të pavlefshme duhet t'i marrë të gjitha biletat të cilat japin të drejtë në udhëtim me beneficion, e të cilat janë të fshira, të përmirësuara, si dhe të huazuara pa autorizim, apo të falsifikuara, respektivisht nëse i përdor ato personi i paautorizuar.

8. Biletat e udhëtimit të marra nga udhëtarët për shfrytëzimin e udhëtimeve me beneficion, duhet që menjëherë pas kthimit nga rruga, konduktori t'i dorëzoj personit të autorizuar në stacionin amë me raportin K-91. Me udhëtarët tek të cilët janë konstatuar parregullsi, me rastin e shfrytëzimit të beneficioneve, duhet trajtuar si udhëtarë pa biletë udhëtimi.

9. Nga aspekti e sigurisë së komunikacionit në rastet e aksidenteve apo situatave tjera, konduktori vepron sipas rregulloreve dhe udhëzimeve përkatëse të komunikacionit.

Neni 30

Procedurat e pagesave shtesë në tren

1. Pagesat shtesë në tren i kryen konduktori.

- Pagesa shtesë bëhet në bazë të biletës së udhëtimit të cilën e tregon udhëtari, nëse vazhdon rrugën përtej destinacionit të planifikuar, apo kur udhëtari nuk ka fare biletë udhëtimi, gjithashtu në rastet të cekura në nenin 15 të këtij udhëzimi.

2. Nëse gjatë dhënies së biletës shtesë, vjen në shprehje pagesa plotësuese dhe nëse shuma e shtesës varet nga ajo se është lajmëruar apo jo, udhëtari vepron sipas dispozitave të Tarifës së Udhëtarëve.

3. Nëse nga një udhëtarë duhet të paguhen shumë pagesa (zgjatja e udhëtimit, etj) paguhet vetëm më një biletë shtesë.

4. Para dhënies së biletës shtesë, konduktori duhet ta llogarisë biletën e udhëtimit gjegjësisht diferencën për relacionet e caktuara dhe eventualisht shtesës sipas rastit të dispozitave të tarifave të udhëtarëve. Lartësinë e pagesës, paraprakisht konduktori ia tregon udhëtarit dhe nëse ky pranon pagesën, konduktori e ekzekuton këtë pagesë.
5. Pas kryerjes së pagesës shtesë, konduktori e bënë pagesën shtesë dhe e shqyen biletën për pagesën shtesë nga blloku e anulon dhe ia dorëzon udhëtarit.
6. Të gjitha pagesat bëhen në valutën zyrtare të Kosovës "€".
7. Bileta e udhëtimit, në bazë të së cilës është kryer pagesa shtesë, ndërsa udhëtimi me tren nuk është realizuar për shkaqe të njohura për kompaninë, konduktori i kthen udhëtarit pjesën e pagesës së bërë.
8. Nëse konduktori, gjatë shikimit të biletave të udhëtimit në të cilën çmimi është shkruar me dorë, konstaton se arka apo arkëtari, ka llogaritur çmimin më të ultë, është i detyruar që udhëtarit të paguaj diferencën e çmimit dhe rastin ta raportoj në formularin K-91 me nënshkrim.
9. Në rastin e ndërrimit të rrugës së udhëtimit, në komunikacionin e brendshëm, nuk ka dallim në çmimin e biletës, konduktori në biletë shënon numrin e trenit dhe datën e kontrollit të biletës.
10. Nëse udhëtarit me biletë të nxjerrë hynë në tren gabimisht, e cila vlen për tjetër udhëtim dhe nëse konduktori e konstaton se nuk është bërë më qëllim ky gabim, i bëhet pagesa adekuate e biletës pa shtesë. Biletën që ka pasur, nëse ende nuk është anuluar, konduktori nuk do ta anuloj dhe e udhëzon udhëtarin në çfarë mënyre të shkoi në stacionin gjegjës.
11. Nëse udhëtarit në vendqëndrim nuk ka marrë biletë udhëtimi direkt, po deri në një stacion destinues, me shenjën verifikuese "Udhëtim i Mëtutjeshme", konduktori bënë pagesën e diferencës në mes biletës së udhëtimit paraprak dhe destinacionit final dhe bëhet pa shtesa tjera.

Neni 31

Lajmërimi i parregullsive

1. Të gjitha parregullsitë të cilat i konstaton konduktori si dhe parregullsitë në tren për të cilat më vonë duhet të sqarohen përpilohet raporti për parregullsitë në formularin K-91. Raporti K-91 përbëhet nga amëza dhe kopja. Kopja i dorëzohet stacionit amë me vërtetimin e pranimit në amëz të cilën e ruan konduktori për një vit.

2. Në raportin K-91 duhet të cekën të gjitha të dhënat mbi parregullsitë të cilat janë të domosdoshme për shqyrtim si dhe rrethanat në të cilat ka ndodh parregullsia, p.sh. të dhënat për biletën e udhëtimit apo dokumentet tjera, lloji i dëmit, shkeljet etj. Pastaj shënimet personale të sakta i cili ka bërë shkeljet apo dëmin e caktuar.

3. Stacioni amë i cili ka pranuar raportin obligohet që menjëherë sipas natyrës së parregullsisë këtë rast drejtpërdrejt duhet të dërgoj tek organet përkatës për shqyrtim.

Neni 32

Revizorët e trenave

1. Për të shikuar se me çfarë kushtesh udhëtojnë udhëtarët, konstaton parregullsitë eventuale dhe mangësitë në punë të ndonjë shërbimi si dhe për të kontrolluar punën e konduktorëve në aspektin e shikimit të rregull të biletave dhe kryerjen e punëve të tjera, si dhe punën e personelit tjetër i cili bën pjesë në transportit e udhëtarëve e me qëllim të ndërmarrjes së masave adekuate për eliminimin e mangësive dhe zhvillimin e shërbimeve në tren kontrollin e bën revizori i trenave. Revizorët e trenave gjatë kryerjes së shërbimit kanë gjithashtu detyrë që t'i kushtojnë kujdes në rregullsi dhe pastërtinë e trenit.

Vrojtimet dhe propozimet lidhur me transportin e udhëtarëve revizorët e trenave i dorëzojnë Trainkos të cilat do të merren në shqyrtim.

2. Duke u bazuar në komplikimet dhe rëndësinë e punëve, revizorët e trenave, krahas përgjegjësiwe profesionale dhe kualifikimeve shkollore duhet të kenë edhe veti tjera që kushtëzojnë kryerjen e këtij shërbimi. Kjo do të thotë që gjatë caktimit të revizorëve të trenave duhet të ketë kujdes që këta persona duhet në detale t'i dinë të gjitha rregullat në fushën e transportit të udhëtarëve, të kenë aftësi vrojtuese si dhe shikimin e tërësishëm të ndërlydhshmërisë në transportin e udhëtarëve dhe sipas mundësisë të dinë së paku një gjuhë të huaj dhe se me punën dhe sjelljet e tyre të jenë shembull për të punësuarit e tjerë në Trainkos.

3. Detyrat e revizorëve të trenave janë:

- Kontrollimi i biletave të udhëtimit me qëllim të konstatimit se konduktorët e kanë kryer kontrollimin e të gjitha biletave të udhëtimit;
- Të konstatoj se konduktorët i kanë kryer në rregull të gjitha detyrat të parapara në nenin 29 të këtij udhëzimi;
- Të verifikoj pamjen e jashtme të konduktorit (uniformën zyrtare, pastërtinë dhe rregullsinë), si dhe sjelljet në raport me udhëtarët;

- Të verifikoj se konduktorët janë të furnizuar me pajisjet e nevojshëm për punë, sasinë e mjaftueshme të formularëve dhe biletave dhe se dorëzimin e pagesave në arkë e kryejnë rregullisht;
- Verifikon se përbërja e garniturës (si tërësi dhe me klasa) i përgjigjet frekuentimit të udhëtarëve në disa relacione si dhe a është i mjaftueshëm numri i konduktorëve.
- Konstaton se rendi i udhëtimit (ardhja, shkuarja, qëndrimi i trenit) i përgjigjet kërkesave reale të udhëtarëve;
- Merr mendimet e udhëtarëve dhe i shënon propozimet, vërejtjet dhe dëshirat eventuale të udhëtarëve lidhur me punën e personelit, orarin e udhëtimit dhe komoditetin gjatë udhëtimit;
- Kontrollon se a janë në rregull pajisjet dhe inventari në vagonë;
- Verifikon pastërtinë dhe mbajtjen e rendit në trena;
- Në periudhën e ngrohjes kontrollon se a ka ngrohje në trena;
- Sipas nevojës bënë pagesën e biletës së trenit me biletën shtesë K-6.

4. Revizorët e trenave bëjnë kontrollin në bazë të orarit të cilin e përpilon Zyra e Kontrollit. Që kontrolli të jetë efikas dhe i pa prituri duhet që në orar të kontrollit sipas rregullave të përfshihen të gjithë trenat e transportit të udhëtarëve. Trenat me frekuentim të madh të udhëtarëve dhe trenat të cilët janë vërejtur parregullsitë apo puna e konduktorëve është vështirësuar për shkak të rrethanave tjera duhet që me orar të parashihen kontrole më të shpeshta.

Nëse gjendja e kërkon të disa trena dhe në disa relacione me orar duhet të parashihen që kontrollimet të bëhen nga dy apo më tepër revizor të trenave.

5. Para se të filloj kontrollimin revizor i trenave është i detyruar që të konstatoj praninë e konduktorit dhe sipas nevojës që të legjitimohet me ID- kartelën e revizorëve të trenave, dhe të merr raportin nga konduktori mbi gjendjen në tren. Te konduktori në pjesën e të cilit dëshiron të bëjë kontroll në amzën e parë të biletës K-2a të pa përdorur shkruan ” Rev data nr. Trenit” me nënshkrim që do të thotë se është kryer kontrolli te ky konduktor dhe se biletat për pagesë shtesë janë dhënë pas kësaj kontrole. Nëse nuk ka konduktor në pjesën e trenit në të cilën dëshirohet të kryhet kontrolli i biletave të trenit, atëherë, kontrollin e kryen pa prezencën e konduktorit dhe për të njëjtën raportin. Revizori i trenit vlerëson se në cilën pjesë të trenit do të filloj kontrollin si dhe a do të kontrolloj tërë trenin apo pjesërisht (te disa konduktorë, në disa vagonë, apo në cilën kupe), që varet nga detyra e pranuar, kërkesave reale dhe rrethanave tjera (situatës në tren, rasteve të komunikacionit), me çka do t’i kushton kujdes që të arrij efikasitet më të madh.

Kontrollin e biletave të trenit sipas rregullave revizori e kryen me prezencën e konduktorit, në të cilën shënon (vulos) me shenjën “R” me të cilën tregon se është kryer kontrolli i biletës nga revizori.

Parregullsitë e konstatuara lidhur me shfrytëzimin e biletave të udhëtimit duhet menjëherë të shqyrtohen, nëse kjo është e mundur, duke pasur parasysh që mos të lëndoje autoritetin e konduktorit dhe të Trainkos-it.

Në rast kur udhëtari është pa biletë të trenit dhe vërtetohet si i ka dhënë konduktorit paratë për biletë të trenit, revizori në këtë rast do t'i merr shënimet nga udhëtari me deklaratën e nënshkruar me shënimet e plota si dhe mundësisht me nënshkrim të një dëshmitari (udhëtari).

Parregullsitë tjera në punën e konduktorit të cilat janë konstatuar me rastin e kontrollit duhet të shqyrtohen pa prezencën e udhëtarit, në mënyrë të qetë, me që vërejtjet e konstatuar duhet të kenë veprim përmirësues dhe edukues.

6. Revizorët duhet të kenë ID-Kartelën gjithmonë gjatë kontrollit. Bartësi i kësaj ID-Kartele është i autorizuar që të kryej punët dhe detyrat e revizorit të trenit në tërë rrjetin e Hekurudhave të Kosovës konform dispozitave të rregullores dhe udhëzimit të transportit të udhëtarëve.

7. Revizori i trenave me rastin e kontrollit shënon në fletoren e tij të gjitha vërejtjet, parregullsitë, si dhe vërejtjet e tij me shënimet përkatëse të cilat i shërbejnë për përpilimin e raportit.

Pas kthimit nga rruga revizori i trenave përpilon raportin e kontrollit i cili përmban:

- Kohën e kaluar në rrugë;
- Kontrollin e trenave dhe shfrytëzimin e ulëseve në trena;
- Kryerjen e pagesave shtesë me rastin e kryerjes së kontrollit;
- Parregullsitë e konstatuara dhe masat e ndërmarra për eliminimin e tyre;
- Vrojtimin, problemet dhe propozimet lidhur me orarin e lëvizjes së trenave, garnitura; shfrytëzimin e trenave, si dhe organizimin e shërbimit të biletarive nëpër stacione
- Propozimet, vërejtjet dhe kërkesat e udhëtarëve.

Pas përpilimit të raportit Revizori i trenave një kopje të raportit ia dërgon udhëheqësit të vet dhe një kopje e mban për vete,

8. Pas pranimit të raporteve nga revizorët e trenave zyra e kontrolli i shqyrton të gjitha mundësitë të cilat nuk janë shqyrtuar në vendin e ngjarjes, ndërsa problemet dhe propozimet e cekura i shqyrton, vlerëson arsyeshmërin e tyre dhe merr masa përkatëse për përmirësimin e tyre. Në bazë të këtyre raporteve kompania mban evidencën me shënimet të cilat janë të nevojshme për analizën e punës së revizorëve.

Neni 33

Ndërprerja e udhëtimit

1. Gjatë udhëtimit ndërprerja e udhëtimit rregullohet në bazë të dispozitave siç parashihen tarifën e udhëtarëve.

Koha e ndërprerjes së udhëtimit kufizohet me kohën e vlefshmërisë së biletës së trenit. Ndërprerja e udhëtimit nuk e vazhdon afatin e vlefshmërisë së biletës së udhëtimit.

2. Nëse udhëtari nuk e ka vërtetuar ndërprerjen e udhëtimit atëherë bileta e udhëtimit nuk vlen për udhëtim të mëtejshëm nga stacioni ku është ndërprerë udhëtimi deri në stacionin destinues.

3. Si ndërprerje e udhëtimit nuk konsiderohet si:

- Kalimi në trenin i cili më herët arrin në stacionin destinues, në krahasim me trenin të cilin ka udhëtuar;
- Kalimi nga treni i cili nuk ndalet në stacionin destinues sipas orarit të lëvizjes së trenave apo në stacionin ku mendohet se do të ndërpritet udhëtimi;
- Pritja në stacionin (nyje) në trenin e parë i cili vjen sipas orarit të lëvizjes së trenave.

Neni 34

Vërtetimi i vlefshmërisë së biletës dhe mos shfrytëzimi i saj

1. Vërtetimi se bileta e udhëtimit është plotësisht e pa shfrytëzuar, është pjesërisht e shfrytëzuar, që do të shfrytëzohet në tren të rangut më të ulët, që iu ka vazhduar afati i vlefshmërisë, e bënë drejtuesi i trenave me kërkesë të udhëtarit, nëse pa dyshim bindet se të dhënat e udhëtarit janë të sakta.

Nëse është në pyetje vendi zyrtar i pa shfrytëzuar vendimin e ndërprerjes së udhëtimit e bënë konduktori. Gjatë udhëtimit kthyes nëse nuk përdoret bileta kthyes vërtetimi i biletës bëhet në stacionin fillestar të nisjes.

Vazhdimin e afatit të biletës ndërkombëtare të udhëtimit e bënë shefi i stacionit fillestar gjegjësisht shefi i stacionit në të cilin është ndërpre udhëtimi.

Afati i vlefshmërisë së biletës ndërkombëtare të udhëtimit mund të vazhdohet vetëm njëherë dhe atë më se shumti për dy muaj.

2. Vërtetimi bëhet në pjesën e pasme të biletës dhe nëse në atë nuk ka vend atëherë bëhet me fletë të posaçme e cila duhet t'i bashkëngjitet fletës së udhëtimit. Kur vërtetimi bëhet me fletë të posaçme në të duhet të shkruhen edhe shënimet e biletës së udhëtimit dhe në biletën e udhëtimit shkruhet “shiko shtojcën” .

Vërtetimi bëhet duke shënuar shënimet përkatëse dhe në fund vendoset vula e stacionit dhe data e lëshimit. Vërtetimi mund të bëhet edhe me vulë përkatëse e cila i përmban shënimet sipas rastit të vërtetimit.

3. Bileta e kthimit e cila nuk do të shfrytëzohet për udhëtim të mëtejme duhet që gjatë vërtetimit të shënohet me një ik-s “X” në pjesën e përparme të saj.

4. Nëse bileta e udhëtimit, e cila plotësisht apo pjesërisht, është e pa shfrytëzuar ku ka qenë i dorëzuar edhe bagazhi, për çka duhet të pyetët edhe udhëtari gjatë vërtetimit në biletën e vërtetimit, duhet të shënohet se bagazhi është dhënë udhëtarit në atë stacion apo është përcjell në stacionin tjetër.

5. Gjatë vërtetimit të vlefshmërisë së biletës rasteve të tjera të vulosura me vulë të stacionit shkruhen këto shënime:

- “ Afati i vlefshmërisë vazhdohet deri ..., ‘
- “ anulimi i gabuar”
- “ Gabimisht e shkoqur vlen tutje”
- “ E pa shfrytëzuar”
- “ Nuk guxon të përdoret prej... deri ...”

6. Nëse personi përgjegjës nuk bindet në deklaratën e udhëtarit në aspektin e mos shfrytëzimit të biletës së udhëtimit apo kalimit të vlefshmërisë së biletës së udhëtimit, në biletë nuk duhet të shënoj as një vërtetim. Udhëtari duhet të informohet me atë që të bënë kërkesë me shkrim për kthimin e parave për biletën e reklamuar, duke shënuar arsyen për mos shfrytëzimin e asaj bilete.

7. Nëse në transportin e brendshëm ndërpritet udhëtimi atëherë drejtuesi i trenave në pjesën e pasme të biletës vërteton ndërprerjen e udhëtimit me fjalët “udhëtimi është ndërprerë”.

8. Të gjitha shënimet të cilat kanë të bëjnë vërtetimin e vlefshmërisë dhe shfrytëzimit duhet të jenë të vulosura të nënshkruara nga personi i dhënë shënimet dhe data kur janë dhënë shënimet.

D) Rastet e veçanta

Neni 35

Mosrespektimi i orarit të lëvizjes së trenave – pengesat në komunikacion

1. Vonesa e trenave për bartjen e udhëtarëve më e madhe se 15 minuta nëpër stacione duhet të lajmërohet me shpallje apo përmes mjeteve tjera të informimit. Pengesat në komunikacion,

stacioni duhet menjëherë t'i lajmëroj me shpallje nëpër të gjitha biletaritë dhe në të të cek rrugën ndihmëse kaluese të cilën mund ta përdorin udhëtarët nëse kjo është e mundshme. Udhëtarët duhet të njoftohen menjëherë për pengesat në komunikacion, zgjatjet e përafërta të saj, për mundësitë dhe mënyrat e transportit të mëtejme, si dhe formalitetet të cilat duhet t'i kryejnë udhëtarët lidhur me përvetësimin e të drejtave të tyre (kur hiqet dorë nga udhëtimi i mëtejme, shfrytëzimin i rrugës ndihmëse dytësore, kthimi në stacionin e nisjes).

2. Me rastin e pengesave në komunikacion dhënien e biletave përtej vendit të ndërprerë mund të jepen vetëm me lejen e kompanisë.

3. Nëse udhëtari për shkak të vonesës së trenit ka humb lidhjen për kyçje, ose për shkak të revokimit të trenit, ose pengesave në komunikacion, të cilat e pamundësojnë vazhdimin e udhëtimit të mëtutjeshëm me tren sipas orarit atëherë ai mund:

- Të heq dorë nga udhëtimi i mëtutjeshëm me kthimin e të hollave për relacionin e pa shfrytëzuar,
- Të heq dorë nga udhëtimi i mëtutjeshëm dhe të kthehet me trenin e parë të përshtatshëm pa pagesë në stacionin e nisjes pa ndërprerje të udhëtimit, me kthimin e parave për tërë relacionin.
- Të vazhdoj udhëtimin. Në këtë rast Trainkos është i obliguar të bartë udhëtarin deri në stacionin destinues me trenin e parë të përshtatshëm, përmes rrugës ndihmëse, ose në një mënyrë tjetër, (nëse transportin e organizon Trainkos-i) pa pagesë të çmimit të udhëtimit.

4. Nëse udhëtari ka heq dorë nga udhëtimi, në stacionin ku ka vendosur ta ndërpret udhëtimin duhet që menjëherë bashkë me biletën e udhëtimit të lajmërohet tek drejtuesi i trenave. Drejtuesi i trenave vërteton biletën e udhëtimit: 'E pa shfrytëzuar prej.... deri, për shkak të humbjes së lidhjes, arsyeja, shkak i humbjes së lidhjes, revokimi i trenit nr. (data dhe nënshkrimi dhe vula e stacionit).

Nëse bileta e udhëtimit nuk sillet menjëherë pas arritjes së trenit për vërtetim, vërtetimi i më vonshëm nuk është i mundur.

5. Nëse udhëtari heq dorë për udhëtimi i mëtutjeshëm dhe dëshiron të kthehet në stacionin e nisjes duhet menjëherë, pas arritjes së trenit në stacionin në të cilin ka heq dorë nga udhëtimi i mëtutjeshëm të sjell biletën e udhëtimit te drejtuesi i trenave. Drejtuesi i trenave përpilon raportin për mosshfrytëzimin e biletës së udhëtimit (K-27), të cilin e vulos me vulën e stacionit me datë dhe i dorëzon udhëtarit, ndërsa në biletën e pa shfrytëzuar të udhëtimit e vënë shënimin sipas pikës 5 raporti (K-27) dhe bileta e vërtetuar e pa shfrytëzuar shërben si biletë e udhëtimit për kthim me trenin e parë të përshtatshëm pa e ndërprerë udhëtimin. Nëse me trenin e parë të përshtatshëm me të cilin udhëtari kthehet nuk ka klasë të dytë për të cilën vlen bileta e tij e udhëtimit, raporti K-27 mund të jepet edhe për klasën e parë, si dhe për tren të rangut më të lartë

nëse nuk ka tren të rangut të njëjtë. Udhëtarit duhet t'i tërhiqet vërejtja se e humb të drejtën e udhëtimit nëse në afat prej 8 ditësh pas kthimit në stacionin e parë të nisjes nuk i lajmërohet drejtuesit të trenave (biletarit) dhe nuk e sjell raportin K-27 për mos shfrytëzimin e biletës së udhëtimit. Drejtuesi i trenave i stacionit të mëparshëm të nisjes vërteton raportin K-27 që udhëtari me kohë e ka lajmërua kërkesën e vet për kthimin e çmimit të udhëtimit, dhe pastaj udhëtarin e udhëzon që të shkojë te biletari i udhëtarëve për kthimin e biletës së udhëtimit, e cila bëhet sipas dispozitave në tarifën e udhëtarëve. Raporti K- 27 i bashkëngjitet biletës së udhëtimit dhe llogarive mujore.

6. Nëse udhëtari në stacionin të cilin ka hequr dorë nga udhëtimi i mëtejshëm nuk mund të dëshmojë që e ka përdorur trenin i cili ka humbur lidhjen, ose që ka pas qëllim të vazhdojë udhëtimin me trenin lidhës në të cilin ka vonuar, ose i cili është revokuar, nuk guxon ti jepet raporti K-27 dhe drejtuesi i trenave në biletën e mëparshme vënë shënimin "e treguar" vulos me vulë të stacionit dhe e nënshkruan. Në këtë rast udhëtari duhet të blejë biletën e re të udhëtimit nëse dëshiron të vazhdojë udhëtimin e mëtejshëm, ndërsa stacioni duhet të udhëzojë që menjëherë pas arritjes së trenit në stacionin paraprak të nisjes të kërkon që në biletën e re të udhëtimit të vihet shënimi dhe t'i drejtohet me shkrim kontrollit të të hyrave me kërkesë për thyerjen e çmimit të udhëtimit, të cilës ia bashkëngjitet të dy biletat e udhëtimit.

7. Në rastet kur udhëtari humb lidhjet për shkak të vonësave të trenave ose për shkak të revokimit të trenave (me rastin e pengesave të ndryshme në komunikacion), dëshiron të vazhdojë udhëtimin, duhet që të njëjtin ta bartin me trenin e parë të mundshëm pa kërkuar pagesë deri në stacionin destinues dhe t'i mundësohet që në stacionin e fundit të arrij me sa më pak vonesë. Në këtë rast drejtuesi i trenave, nëse është e nevojshëm vërteton biletën e udhëtimit që vlen për klasë të parë, për trenin e rangut më të lartë ose për rrugë tjetër kaluese. Me rastin e vërtetimit të biletës së udhëtimit për rrugën tjetër kaluese duhet saktë të ceket, rruga e re kaluese dhe sipas nevojës të vazhdohet afati i vlerës së udhëtimit, ku me këtë rast merret parasysh distanca në mes të stacionit të nisjes deri në stacionin destinues përmes rrugës së re kaluese sipas dispozitave të tarifës së udhëtarëve për afatin e vlefshmërisë së biletës së udhëtimit. Vërtetimi i kësaj bilete bëhet: treni, ka (humb lidhjen) vlen, për klasën, trenin nr....., prej, deri, data, nënshkrimi, dhe vula e stacionit.....,

8. Për vërtetimin e biletave me rastin e humbjes së komunikacionit ndërkombëtarë vlejshëm të njëjtat rregulla si në komunikacionin e brendshëm.

Neni 36

Procedura kur udhëtari nuk pranon ta paguaj biletën shtesë në tren

Procesi mbi mos pagesën e biletave në tren K-92

1. Procesin mbi mos pagesën e biletave në tren K-92, konduktori e përpilon në rastin kur udhëtari refuzon të paguaj biletën e udhëtimit, ndryshimin në çmim, biletën shtesë ose dëmtimet e ndryshme në tren.
2. Procesi K-92 është formular, i cili përbëhet nga amëza dhe kopja. Amëza është me ngjyrë të bardhë, ndërsa kopja ngjyrë roze. Procesi K-92 është i lidhur në fletore prej 25 fletëve me kopje, janë të vulosura me vulë të thatë. Fletoret e procesit K-92 numërohen për çdo stacion amë me numra prej 0001 deri në 10000, ndërsa fletë e çdo fletoreje me numër 01 deri në 25.
3. Porosia, furnizimi i konduktorëve me procese K-92, dorëzimi i amzave të përdorura, evidenca e harxhimit dhe rezervave, llogaritja e shumave të paguara sipas proceseve K-92 bëhet sipas dispozitave të rregullores 182.
4. Për çdo fletore të procesit K-92 udhëhiqet regjistri i posaçëm K-61. Regjistri K-61 ka 25 rubrika horizontale të numëruara nga 01 deri në 25 në të cilat shënohen të gjitha proceset K-92 të përdorura.
5. Para se të shënohen shënimet në regjistrin K-61 duhet të vlerësohet arësyeshmëria dhe saktësia e çdo procesi K-92 të plotësuar.
6. Konduktori i cili ka përpiluar procesin K-92 apo punëtori i stacionit i cili e ka kontrolluar këtë proces për nga arësyeshmëria dhe saktësia janë përgjegjës për shumën e llogaritur në procesin K-92.
7. Udhëtari duhet, sipas obligimit të përshkruar në procesin K-92 që shumën e llogaritur ta paguaj në afat prej 15 ditëve duke llogaritur nga data e plotësimit të procesit K-92.
8. Nëse udhëtari në afat prej 15 ditëve nuk e paguan shumën e borxhit sipas procesit K-92, stacioni (Trainkos) është i obliguar me shkrim t'i tërheq vërejtjen për kryerjen e obligimit të pagesës përmes postës, me vërejtje që në të kundërtën do të ngritët padia në gjykatë.
9. Nëse në afat prej 30 ditëve nga dita e njoftimit të udhëtarit për borxhin që ka udhëtari dhe nuk është për pagesa, atëherë Zyra Ligjore e Trainkos-it ngrit padia në gjykatën përkatëse ndaj udhëtarit. Nëse udhëtari paguan borxhin pas ngritjes së aktpadisë atëherë stacioni njofton Zyrën

Ligjore për tërheqjen e aktpadisë. Pas realizimit të shumës së padisë Zyra Ligjore njofton shërbimin e kontrollit dhe stacionin i cili ka lëshuar K-92 se është realizua aktpadia. Nëse Zyra Ligjore nuk ka mundur të ngrit padi në gjykatë, apo nuk ka mundur t'i realizoj kërkesat e padive, të cilat për këtë arsye duhet të stopohen, lëndën komplet me një arsyetim ia dërgon shërbimit të kontrollit.

10. Në rastet e arsyeshme kontrolli i të hyrave mund me kërkesën e stacionit amë të heq dorë nga pagesa sipas procesit K-92, për të cilën kërkesë bien vendime me shkrim dhe ia dërgojnë stacionit. Nr e vendimit, stacioni e regjistron në rubrikën përkatëse në K-61 sipas vendimit të kontrollit së të hyrave. Nëse kontrolli i të hyrave nuk e aprovon propozimin e stacionit për heqjen dorë nga pagesa, lëndën ia kthen stacionit për kryerje të pagesës dhe e udhëzon si të veprojt.

11. Kopjet e proceseve K-92, të regjistrave K-61 dhe vendimin e Kontrollit për heqje dorë nga pagesa stacioni amë i ruan në arkivin e vet tri vite.

Afati i ruajtjes së regjistrave të përdorur K-61 fillon të rrjedh nga data kur stacioni i ka kryer procedurat e nevojshëm për të gjitha 25 kopjet e K-92 të fletores përkatëse.

Procedura kur udhëtari nuk mund ose nuk pranon ta paguaj biletën në tren

12. Udhëtari i cili nuk mundet ose nuk pranon të paguaj pagesat e parapara në tren, duhet t'i ndërpritet udhëtimi i mëtejshëm në stacionin e parë kur treni ndalet sipas orarit, pasi të jetë plotësuar, procesi K-92 deri në atë stacion. Në rastet të veçanta procesi K-92 plotësohet deri në stacionin destinues të udhëtarit nëse është në pyetje fëmija deri në moshën 14 vjeçar. Për udhëtarët tjerë procesi K-92 mund të plotësohet deri në stacionin destinues të udhëtarit vetëm atëherë kur vërtetohet identiteti i tij dhe ato:

- a. Udhëtari me fëmijë deri në moshën 7 vjeçar
- b. Invalid të rënd dhe të verbëritë
- c. Punëtorët, zyrtarë dhe ushtarak nëse udhëtojnë me urdhëresa për udhëtime zyrtare
- d. Punëtorët hekurudhor dhe anëtarët e familjes së ngushtë nëse legjitimohet
- e. Personi të cilin organi kontrollues ose shefi i stacionit destinues vlerëson ose garantojnë se pagesa do të kryhet në fund të udhëtimit.

Udhëtari i cili nuk paguan dëmtimin e shkaktuar në tren dhe ka biletë të udhëtimit nuk ç'kyqet nga udhëtimi i mëtejshëm nëse është vërtetuar identiteti i tij.

13. Sipas rregullave për çdo udhëtarë plotësohet K-92 i veçantë. Nëse udhëtojnë bashkërisht shumë anëtarë të një familje mund të plotësohet një proces K-92 të cilën duhet ta nënshkruaj anëtari më i vjetër i familjes. Te udhëtimet kolektive përpilohet një proces K-92 vetëm atëherë

kur udhëheqësi i grupit merr përgjegjësi për të gjithë pjesëmarrësit e udhëtimit kolektiv dhe nënshkruan procesin K-92 për pagesën sipas procesit.

14. Me rastin e përpilimit të procesit K-92 konduktori vepron në këtë mënyrë:

1. Në rubrikat e parapara shënon datën, numrin dhe llojin e trenit në të cilin është përpilon procesi.
2. Vërteton shënime personale (identitetin) e udhëtarit në bazë të letërnjoftimit dhe i shënon në rubrikat përkatëse. Konduktori është përgjegjësi kryesor nëse pagesa nuk mund të kryhet shkak i shënimeve të mangëta, të pa sakta ose të pa lexueshme të cilat i ka shënuar në proces.
3. Si arsye e pagesës sipas këtyre rasteve:
 - Nuk ka biletë të udhëtimit, kur udhëtari nuk ka fare biletë ose ka treguar biletën e udhëtimit e cila nuk ka qenë e vlefshëm.
 - Shfrytëzon klasën e parë, trenin me rang më të lart ose shfrytëzon rrugën më të gjatë të udhëtimit, nëse udhëtari tregon biletën e udhëtimit e cila nuk vlen për klasën, trenin, rangun e trenit dhe rrugën kaluese.
 - Me rastin e dëmtimit të trenit si psh:(thyrja e dritares, keqpërdorimi i frenit ndihmës në vagonin nr. ... si dhe ka shkaktuar dëmtime të tjera për të cilat duhet të paguhet në tren. Kopjen e procesit K-92 të nënshkruar, konduktori pas plotësimit e nënvizon dhe të njëjtën ia dorëzon udhëtarit e cila i shërben si biletë udhëtimi e cila i vlen deri në stacionin e ç'kyçjes respektivisht deri në stacionin e destinuar të udhëtarit nëse udhëtarit nuk i është ndërprerë udhëtimi i mëtejshëm. Afati i vlerës së kopjes së procesit K-92 është i njëjtë sikurse biletat e udhëtimit në një drejtim. Në këtë rast ndërprerja e udhëtimit nuk është e lejuar.

15. Në rast kur udhëtari nuk ka letërnjoftim ose kundërshton t'ia jap për shikim konduktorit duhet të kërkoj ndihmë nga sigurimi në tren. Nëse edhe me prezencën e sigurimit nuk mund të vërtetohet identiteti i udhëtarit, konduktori shënon në procesin K-92 vetëm ato shënime të cilat i përkasin pagesës (relacionin, klasën, numrin e personave dhe shumën e pagesës) si dhe shkakun e pagesës.

Në stacionin e parë në të cilin ka policë kujdestarë, konduktori dorëzon udhëtarin dhe kopjen e procesit K-92 drejtuesit të trenave, i cili është i obliguar që në amzë në rubrikën përkatëse të shënoj pranimin. Veprimi i njëjtë është edhe në rastin kur udhëtari refuzon të nënshkruaj procesin K-92. Nëse në tren nuk ka sigurim, policë, konduktori pas përpjekjeve nuk ka mundur që udhëtarin ta dorëzoj në stacionin ku ekziston policia kujdestare dhe deri në stacionin ku e ka përpiluar procesin K-92, shkak se udhëtari nuk dëshiron të vazhdoj më tutje udhëtimin, konduktori e zbrit udhëtarin në stacionin e parë ku treni ndalet sipas orarit të udhëtimit dhe ia

dorëzon drejtuesit të trenave. Drejtuesi i trenave është i obliguar që të pranoj udhëtarin dhe kopjen e procesit K-92 dhe të verifikoj identitetin e tij. Nëse drejtuesi i trenave nuk ka mundur të bëjë pagesën e as identitetin e udhëtarit, ai duhet që lidhur me këtë të raportoj me shkrim te shefi i stacionit.

16. Nëse udhëtari e paguan shumën, menjëherë plotësohet rubrikat e evidencës së procesit K-92.

Neni 37

Procedurat e veçanta për stacionet kufitare

1. Kur organet shtetërore të shtetit fqinjë (hekurudhore, sanitare, shëndetësore etj) nuk lejojnë hyrjen në shtetin e tyre, me këtë edhe vazhdimin e udhëtimit të udhëtarëve – Shtetas së Republikës së Kosovës të cilët kanë bileta valide (në një drejtim) (shkuarje), dhe ndërkohë paraqitet nevoja që këta udhëtarë duhet të kthehen nga stacioni ynë kufitar për në stacionin e mëparshëm të nisjes, atëherë me kërkesën e udhëtarit stacioni kufitar vepron në këtë mënyre:

- Vërteton biletën ndërkombëtare të udhëtimit si të pa shfrytëzuar për pjesën e relacionit të pashfrytëzuar të shteti fqinjë me shënimin e pa shfrytëzuar në pjesën prej.. deri...;
- Caktojnë stacionin destinues për kthim deri te cila udhëtari dëshiron të udhëtoj (sipas rregullave duhet të jetë stacioni i mëparshëm i nisjes);
- Përpilon procesin K-92 duke i plotësuar të gjitha rubrikat nga stacioni kufitar deri në stacionin e ri të destinuar. Në pjesën e sipërme të procesit K-92 shënohet shënimi ku udhëtari e ka bashkëngjitur biletën ndërkombëtare të udhëtimit të dhënë nga arka numër e stacionit dhe vërteton për relacionin e pa shfrytëzuar prej - deri. Në rubrikën shkakun e pagesës shkruhet: Kopja vlen si biletë e udhëtimit klasa e dytë, treni ... nga stacioni kufitar, deri te stacioni, kopja e procesit K-92 i dorëzohet udhëtarit si dëshmi për kthim në stacionin e mëparshëm.
- Amëza e procesit K-92 e vërtetuar i bashkëngjitet biletës ndërkombëtare të udhëtimit të pa shfrytëzuar dhe me akt përcjellës i dërgohet kontrollit të të hyrave. Akti përcjellës duhet të përmbaj arsyetimin për cilat shkaqe udhëtari nuk ka mundur të vazhdoj udhëtimin deri në stacionin e destinuar si dhe shënime personale të udhëtarit të marr nga pasaporta si dhe rrethanat tjera të arsyeshme të cilat kanë ndikuar për arësyeshmërinë e përpilimit të procesit K-92.
- Nga udhëtari nuk kërkohet kërkesë e posaçme me shkrim për kthimin e çmimit të biletës për relacionin e pa shfrytëzuar, por vetë nënshkrimi i procesit K-92 paraqet në këtë rast kërkesën e tij për kthimin e ndryshmit. Kjo procedurë nuk është e paraparë për stacionet tjera në rrjetin e Hekurudhave të Kosovës dhe të njëjtat nuk mund të zbatohen.

Neni 38
Regjistri i biletave dhe formularëve të TU

Regjistri i biletave dhe formularëve të cilët përdoren në transportin e udhëtarëve do të jenë shtojcë e këtij udhëzimi dhe do të miratohen me vendim të veçantë.

Neni 39
Detyrimet për pronarin e Infrastrukturës

Të gjitha detyrimet që dalin nga ky udhëzim për pronarin e Infrastrukturës, duhet të merren parasysh dhe të zbatohen gjatë marrëveshjes për shërbime të përbashkëta.

Pjesa e III
Dispozitat përfundimtare

Neni 40

Ky udhëzim shfuqizon udhëzimet e mëparshme mbi organizimin e transportit të udhëtarëve.

Neni 41

Ky udhëzim hyn në fuqi më datën 01.01.2015


Heset ÇAKOLLI

Kryesues i Bordit të HK-Trainkos Sh.A.